

Mumin Shehu

**KUR'ANI DHE HADITHI
NXISIN PËR DITURI**

Kaçanik, 2006

Autor:
Mumin Shehu

Titulli:
KUR'ANI DHE HADITHI NXISIN PËR DITURI

Recensent:
Dr. Musli Vërbani

Korrektorë gjuhësor:
**Pr. Mustafë Krivenjeva dhe
Pr. Daut Shehu**

Shtypi:

Prishtinë, 2006

2

PARATHËNIE

Të gjitha falënderimet i takojnë All-llahut - Zotit të gjithë botëve, ndërsa paqa dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi të Dërguarin e fundit - Muhammedin s.a.v.s., mbi familjen e tij, shokët e tij, dhe mbi të gjithë ata, të cilët e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Kijametit.

Ky libër, me titull “Kur’ani dhe hadithi nxisin për dituri”, shtjellon çështjet të cilat kanë të bëjnë me kërkuesin e diturisë, me lejen e Allahut, për ta nxitur atë që të vazhdojë në kërkim të dijes, duke i ofruar ajete dhe hadithe që tregojnë atë se, çfarë rëndësie ka kërkimi i diturisë, pastaj t’i njoh obligimet e tija ndaj saj, pastaj çka duhet të ketë kujdes si kërkues i dijes, si dhe detyrat e tjera, të cilat kanë të bëjnë me kërkuesin e diturisë, dhe dijetarin.

Nëse dëshirojmë të flasim se çfarë vlere dhe rëndësie i jep Kur’ani diturisë do të shohim se numri i ajeteve të kësaj natyre e tejkalon njëqindëshin, ndërsa sa i përket haditheve, ato janë të shumta dhe të panumërta.

Kësaj teme do t’iu qasemi nga këndvështrimi i Kur’anit dhe haditheve të Pejgamberit a.s., pasi që dihet se Zoti i Madhëruar për Muhamedin a.s., në suren En-Nexhm, ajeti 3-4, thotë:

“Dhe ai nuk flet nga mendja e tij, Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet”.

Temat që tregojnë vlerën dhe rëndësinë e diturisë, janë ndër temat shumë të rëndësishme, pasi që dihet se çdo çështje e njeriut, në çdo pore të jetës, ndërlidhet me mendjen dhe diturinë. Andaj, nëse njerëzit e kuptojnë vlerën dhe rëndësinë e diturisë, atëherë sigurisht do t’i qasen kërkimit të saj.

Këtë temë e kam përfshirë në 7 kapituj kryesorë, të zgjeruar në nëntituj tjerë, duke filluar nga vlera e diturisë dhe e dijetarëve, obligimet e tyre ndaj diturisë, nxitja në kërkimin e diturisë nga ajetet Kur'anore dhe hadithet e Muhamedit s.a.v.s., duke përfshirë edhe atë se çka duhet të ketë kujdes dijetari apo kërkuesi i diturisë.

Në fillim të ajeteve Kur'anore të përkthyer në gjuhën shqipe kam përdorur shprehjen "Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë", kjo shprehje i dedikohet asaj që e thotë Zoti i Madhëruar në Kur'an në gjuhën arabe, ngase çdo përkthim, në çdo gjuhë tjetër, nuk mund ta përfshijnë tërë atë që Zoti i Madhëruar ka dashur të thotë, si dhe çdo fjalë dhe çdo shkronjë e Kur'anit në gjuhën arabe është mrekulli (mu'xhize). Prandaj, përkthimi i ajeteve në gjuhën shqipe është vetëm përkthimi i domethënieve të ajeteve Kur'anore.

Në fund mbrojtjen dhe shpërblimin e kërkoj vetëm nga All-llahu, kurse paqë mëshira dhe përshëndetjet qofshin mbi Pejgamberin s.a.v.s, ndërsa falënderimi i takon All-llahut - Zotit të gjithë botëve.

Mumin Shehu
28. 11. 2006

KAPITULLI I PARË

I

VLERA DHE RËNDËSIA E DITURISË DHE E DIJETARËVE NGA KËNDVËSHTRIMI I KUR'ANIT DHE I HADITHEVE

- DITURIA BEGATI NGA ALL-LLAHU I MADHËRUAR
- DISA NGA DOBITË E DITURISË
- DITURIA KULMINACIONI I IBADETIT
- QORTIMI I INJORANCËS DHE I TË PADITURVE
- DITURIA I LARTËSON DIJETARËT MBI TË TJERËT

VLERA DHE RËNDËSIA E DITURISË DHE E DIJETARËVE NGA KËNDVËSHTRIMI I KUR'ANIT DHE I HADITHEVE

Kur flasim për diturinë, kemi të bëjmë me çështje shumë të rëndësishme të njeriut si krijesë në natyrë. Lidhja e njeriut me Krijuesin e tij, pastaj me shoqërinë, rrethin ku jeton dhe me natyrën, pikërisht bëhet përmes diturisë. Prandaj mendja është dhurata më e çmuar e njeriut nga Zoti i Madhëruar.

...

“Ne vërtet nderuar bijtë e Ademit (njerëzit) ...”.

(El-Isra, 70)

Kjo është edhe çështja në të cilën Zoti i Madhëruar e ka dalluar njeriun nga gjallesat tjera.

Çdo gjë që ka të bëjë me jetën e njeriut, në veprimet e tij ndërlihet me mendjen dhe diturinë. Zoti i Lartmadhëruar nuk urdhëron për një çështje, përpos nëse ajo çështje është me vlerë dhe rëndësi. Prandaj, në Islam urdhri i parë dhe çështje kryesore e besimit është për të kërkuar dituri:

.()

“Lexo, me emrin e Zotit tënd , i cili krijoi (çdo gjë)”. *(Alak ,1)*

Betimi i parë i Zotit të Madhëruar në Kur'an është, betimi në lapsin , penën dhe në rreshtat e tij:

.()

“Nun, betohem në penën (lapsin) dhe në atë çka shkruajnë”. *(Kalem,1)*

Prandaj, të merresh me diturinë dhe të flasësh për të, bie në punët më të vlefshme të njeriut, pasi që edhe Zoti nuk përbetohet, vetëm se në atë që është me vlerë dhe rëndësi.

Dituria, e kundërta e saj është injoranca (padituria). Këto janë dy gjëra jo të barabarta, ashtu siç nuk është e barabartë drita me errësirën. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.()

“...Thuaj a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Po vetëm të zotët e mendjes marrin mësim”.

(Ez –Zumer-9)

Përgjigjja është se nuk janë të barabartë, ngase të diturit janë në shkallë më të lartë. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.()

“... All-llahu lartëson ata që besuan prej jush , i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri...”.

(El-Muxhadele, 11)

Begatia dhe vlera e diturisë tregohet në formë përmbledhëse edhe në hadithin vijues. Nga Ebu Ed-Derdan r.a. transmetohet se ka thënë:

“ E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahu s.a.v.s. duke thënë:

"Kush niset për në rrugë duke kërkuar dije , All-llahu do t'ia lehtësojë rrugën për në xhennet. Vërtetë edhe melekët i shtrijnë krahët e tyre në mbrojtje për kërkuesin e dijes nga kënaqësia me veprën e tij. Për dijetarin falje kërkon çdo gjë në qiej dhe në tokë e madje edhe peshqit në ujë. Vlera e dijetarit ndaj robit të devotshëm është sikur që është vlera e hënës ndaj planetëve të tjera. Vërtetë dijetarët janë trashëgimtarë të Pejgamberëve ; Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinarë as dërhëmë, ata vërtetë kanë lënë për trashëgimi dijen , prandaj kush e merr , e ka marrë masën (hisen) e mjaftueshme".¹

Transmetohet nga Ibni Umeri se Pejgamberi a.s. ka thënë:

. () :

"Derisa flija më kanë sjellë një gotë qumësht. Aq kam pirë sa që kam hetuar se më është shuar etja , sikur ajo (etja) nëpër thonj të më dilte . Atë që më mbeti ia dhashë Umer b. Hattabit". "O Resulull-llah, si e shpjegon ti këtë?" i thanë. "Me dituri, tha Pejgamberi s.a.v.s." .²

Pirjen e qumështit në ëndërr, Muhamedi a.s. e krahasoi me mësimin dhe grumbullimin e njohurive , duke pasur parasysh dobinë e tyre për individin dhe për shoqërinë . Qumështi është ushqim për trupin , kurse shkenca (dija) për ngritjen shpirtërore.

Dituria është ajo që të varfrit i ka ulur në vendet ku ulen mbretërit. Transmetohet se Ibni Abbasi ka thënë se Sulejmanit a.s. i është parashtruar të zgjedhë: "Pasurinë" apo "Fuqinë" ose "Diturinë". Ai e ka zgjedhur diturinë, ku në saje të saj e fitoi postin mbretëror (fuqinë) edhe pasurinë.³

¹ "Sunenu Tirmidhij", vëll.5, fq.48, nr.2682,

² "Fet'hul Bari", Ibn Haxher el Askalani, vëll.I, Fq.242, h.82 boton Darul Fikri, botimi i pare, Bejrut 1993.

³ "Ihja Ulumud din", Imam Gazali, vëll.I, fq.6, botimi i dytë, 1316 hixhrij-1895, botuar në Ez-her të Egjiptit.

Me një fjalë në kërkimin e diturisë qëndron lumturia në këtë dhe në botën tjetër.

Imam Shafiu ka thënë:

*“Kush e dëshiron këtë botë le të kërkojë diturinë, kush e dëshiron botën tjetër le të kërkojë diturinë, kush i dëshiron të dyjat prapë le të kërkojë diturinë”.*⁴

Vlerën dhe rëndësinë e diturisë dhe dijetarëve do ta shtjellojmë përmes nëntitujve në vazhdim:

1. DITURIA BEGATI NGA ALL-LLAHU I MADHËRUAR

S'ka krijesë që e krijoi All-llahu dhe e nderoi më shumë se atij që ia dha mendjen .

All-llahu është Krijuesi i çdo krijese. Ai është i Gjithëdijshmi.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

(... ..)

“... (Allahu) E di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen ...”. (*El-Bekaretu*, 255)

Dija dhe njohuria e Zotit është gjithëpërfshirëse, e papërcaktuar në kohë dhe hapësirë. Ai është i njohur për të gjitha ndodhitë e së kaluarës, të së tashmes dhe të së ardhmes.⁵

Një studiues i mirënjohur i islamistikës në librin e tij “Fet’hul Bejan” lidhur me domethënien e kësaj fjalie, thotë: *“Dituria e Zotit përfshinë të gjitha informacionet, nga Ai nuk mund të fshihet asgjë nga gjendja e gjithë krijesave të Tij, bile*

⁴ E ka përmendur Imam Neveviu në "El-Mexhmu", vëll.I, f.12.

⁵ "Tefsir Et-Taberij", vëll.V, fq.396.

as gjendja e buburrecit të zi, në natën e errësuar, nën gurin e tokës së pluhurosur, as peshku në thellësinë më të madhe të ujit”.⁶

Përemri lidhor ."ma" { }, i cili në këtë rast ka formën e trajtës së pashquar jep të kuptosh gjeneralisimin e njohurive të Zotit për çdo send, i vogël qoftë ai a i madh.

- All-llahu i jep dituri kujt të dojë dhe sa të dojë. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(... ...)

“... nga ajo që Ai di, të tjerët dinë vetëm sa ka dëshiruar Ai ...”. (*El-Bekare,255*)

Përmes kësaj fjalie, kuptohet fakti se njohuritë e Zotit nuk mund t'i zbulojë askush, përveç atyre që shpalosen me dëshirën e Tij, pastaj qenien dhe cilësitë e Tij, nuk ka dije që mund t'i përthekojë, pos asaj që Zoti vetë ua ka bërë të njohur njerëzve.⁷

Me këtë fjali të kësaj pjese të Kur'anit demantohen mendimet e gjithë atyre që mendojnë se Pejgamberët dhe disa njerëz të mirë e kanë ditur ose dinë gajbin (të fshehtën).

Këtë supozim të tyre e hedhin poshtë shumë dëshmi nga Kur'ani dhe Suneti. Në Kur'an thuhet se engjëjt nuk i dinin emrat e gjërave që ua kishte paraqitur para tyre Zoti i Madhëruar⁸; pastaj, xhinët nuk dinin për vdekjen e Sulejmanit a.s.; Ademi a.s., nuk dinte për mashtrimet e shejtanit.⁹ Ibrahim i a.s. nuk dinte paraprakisht për rezultatin përfundimtar rreth

⁶ "Fet'hul Bejan", vëll.I, fq.423.

⁷ "Tefsir Et-Taberij", vëll.V.

⁸ (*shiko në Kur'an, El-Bekare, 30-33*)

⁹ (*shiko në Kur'an, El-E'araf, 19-23*)

therjes së birit të tij;¹⁰ Jakubi a.s., nuk dinte për vendndodhjen e birit të tij, Jusufit a.s;¹¹ Sulejmani a.s., nuk dinte për shkaqet e mungesës së Hud Hudit.¹²

Ngjarjet e lartpërmendura janë fakte të pamohueshme, të cilat dëshmojnë se gajbin (të fshehtë) nuk mund ta dijë askush nga njerëzit, prej të cilëve nuk janë përjashtuar as vetë pejgamberët e Zotit xh.sh., përveç nëse Ai i lajmëron për të.¹³

Prandaj, nga e tërë kjo që theksuam, dëshiroam ta përkujtojmë atë se - padyshim dituria është begati e dhuruar nga Zoti, e kjo manifestohet që nga krijimi i njeriut të parë, Ademit a.s..Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

(...)

“(Përkujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve : Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës”. (El- Bekare,30)

Melekët në fillim shprehën çudi se si po e krijon atë, i cili kur ta ndien veten të pavarur bën shkatërrime në tokë. Mirëpo Zoti i Madhëruar e ka ditur se njeriu si mëkëmbës në tokë është i ngarkuar me përgjegjësi të rëndë .

Andaj njeriu që të ketë mundësi përmbushjen e këtij amaneti, Zoti i Madhëruar ia dhuroi mendjen dhe diturinë:

.(...)

“ E ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve)”. (El-Bekare, 31)

¹⁰ (shiko në Kur'an, Es-Safat, 102-111)

¹¹ (shiko në Kur'an, Jusuf, 84-86)

¹² (shiko në Kur'an, En-Neml, 20-28)

¹³ "Takvimi 2004" tema "Ajete "El-Kursijj" dhe vlera e tij" Mr.Xhabir Hamiti, fq.7.

Kur melekët u pyetën për ato emra ata nuk i dinin . E si ishte përgjigjja:

()

“(Engjëjt) thanë: “ Ti je i pa të meta , ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë Ti je i gjithëdijshmi i Urti!”. *(El-Bekare,32)*

Prandaj, çdo zbulim shkencorë; çdo e arritur; çdo dijeni..., e shfaqur në këtë botë, nuk është gjë tjetër, pos dhuratë nga Zoti i Madhëruar e dhënë robërve të Tij.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

.()

“I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. *(El Alak , 5)*

Pra All-llahu është dhurues i çdo të mire, e po ashtu edhe i diturisë. All-llahut i takon dija absolute, ndërsa njeriu di aq sa dëshiron Krijuesi i tij.

1. DISA NGA DOBITË E DITURISË

Dobi kryesore e diturisë është besimi (Imani), për këtë shohim se Kur'ani sa herë që ka përmendur diturinë, aq herë e ka përmendur Imanin.

Fjala “ILM” (dituri), së bashku me fjalën “MEARIFE”, e cila ka domethënien e fjalës “NJOHURI”, me trajtat e tyre të përsëritura në Kur'an, gjithsejtë është përsëritur 811 herë, po aq sa është përsëritur fjala “IMAN” (BESIM).

- Besimi (akideja) në Islam qëndron në bazë të diturisë dhe shkencës, jo në dorëzimin verbal. Lidhur më këtë Kur'ani thotë:

()

“ Atëherë, dije se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, ...“.

(Muhamed 19)

Pra besimi (imani) është i varur nga dituria.

S'ka dyshim se dituria e vërtetë udhëzon në besim. Besimi i vërtetë hap shtigjet, i krijon mundësitë për dituri. Andaj këta dy (besimi dhe dituria) janë si dy vëllezër që e ndihmojnë njëri-tjetrin.

- Gjithashtu dituria është themeli i frikës nga Zoti i Madhëruar:

()

“...Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët...”. *(Fatir, 28)*

- Dituria e përfituar në rrugën e drejtë është mjeti më i fortë në fuqizimin e një bashkësie, është më i fortë se çdo dredhi edhe e njerëzve edhe e shejtanit. Vështro rastin e Sulejmanit a.s.

Kur Sulejmani a.s. kërkoi që t'ia sjellin fronin Belkises, atëherë njëri prej xhinëve të vrazhdë (Ifriti) tha se unë do ta sjellë at ty, para se të ngrihesh nga vendi yt, unë për këtë kam fuqi dhe jam i sigurt!

.(...)

“ E ai, i cili kishte dituri nga libri tha:” Unë ta sjelli at sa çel e mbyll sytë (këtij i tha sille)!”.

(En – Naml, 40)

Pra, dituria e fituar nga libri është më e fortë se çdo mjeshtri a dredhi.

Islami i kushton rëndësi të posaçme diturisë, meqë është bazë për përparimin e njerëzve në këtë botë dhe lumturi në botën tjetër.

Dituria është mjet me të cilin besimtari me veprat e tija të mira e arrin kënaqësinë e All – llahut.

Përmes diturisë njeriu përvetëson mjeshtri dhe profesione të ndryshme, me të cilat arrin ta fiton rizkun e përcaktuar nga All – llahu i Madhëruar; në ushqim, veshmbathje dhe nevoja tjera. Gjithashtu me dituri bëhen strategjitë luftarake, pastaj me dituri prodhohen mjete të ndryshme, për nevoja të ndryshme. Me një fjalë dituria është themeli i çdo çështje që ndërlidhet me jetën e njeriut.

- Gjithashtu dituria bën që njeriu të jetë i frenuar. All – llahu i Madhëruar i ka përshkruar pjesëtarët e popullit të Musait a.s., të cilët të mahnitur e shikonin Karunin, i cili kishte pasuri të madhe. Atëherë, ata, të cilëve ua kishte ëndja për pasurinë e kësaj bote, thanë:

()

“.... Ah, të kishim pasur edhe ne si i është dhënë Karunit, vërtet ai është me fat të madh!”. (El-Kasas,79)

Ndërsa, qëndrimi i atyre, të cilëve iu është dhënë dituri, tregohet në këtë ajet:

)

(

“E ata, të cilët ishin të zotët e diturisë thanë: “Të mjerët ju , shpërblimi i All-llahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç durimtarëve!”. (El-Kasas,80)

1. DITURIA KULMINACIONI I IBADETIT

a). Vlera e diturisë ndaj ibadeteve vullnetare

Pasi që me fjalën “IBADET” (adhurim) nënkuptojmë çdo vepër të mirë me të cilën është i kënaqur All-llahu i Madhëruar, atëherë s'ka dyshim se këtu bën pjesë edhe kërkimi i diturisë.

Transmetohet nga Rebia ibn Enes se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“ Kush niset në rrugë me qëllim që të kërkojë dituri, ai është në rrugën e All-llahut derisa të mos kthehet nga ajo rrugë”.*¹⁴

Kërkimi i diturisë është ibadet më i vlefshëm se ibadetet vullnetare (nafîle).

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

...

*“Kërkimi i diturisë është më i mirë se ibadeti nafîle”*¹⁵

Transmetohet nga Ebu Dherri dhe Ebu Hurejra r.a. se ata të dy kanë thënë:

*“Një dituri, të cilën e mëson njeriu, është me e dashur te unë se sa ai, i cili i falë njëqind rekate namaz nafîle (vullnetare)”.*¹⁶

S'ka dyshim se me ibadete vullnetare besimtari afrohet tek All-llahu i Madhëruar, njëherit shpërblimi për to është i madh.

¹⁴ "Sunen Et-Tirmidhij", vëll.V, fq.29, nr.2647, (Tirmidhiu thotë se ky hadith është hasen garib, d.m.th. e kanë transmetuar disa dhe nuk e kanë përcjellë deri te Pejgamberi a.s.).

¹⁵ "El-Mu'xhemul Evset", Taberani, vëll.4, fq.197, nr.3972, Kajro 1994.

¹⁶ Transmeton El Bezzari nr. 138.

Mirëpo, duhet pasur kujdes atë që ka thënë Hasan El Basriju (All-llahu e mëshiroftë):

“...Kërkoni diturinë në atë mënyrë që nuk e dëmton adhurimin, dhe kërkoni adhurimin në atë mënyrë që nuk e dëmton diturinë (shkencën) ...”.¹⁷, që do të thotë, bën adhurim duke mos e lënë anash kërkimin e diturisë.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata ta kuptojnë (e të ruhen)”.

(Et-Tevbe, 122)

b). Vlera e diturisë ndaj xhihadit

Në listën e vlerës së diturisë ndaj ibadetit (adhurimit) është edhe vlera e diturisë ndaj xhihadit (luftë për rrugën e All-llahut), i cili është kulmi i Islamit.

Vlera e xhihadit nuk dihet pos me dituri. Kushtet dhe parimet e xhihadit nuk bëhen të qarta, pos me dituri. Gjithashtu nuk mund të shpjegohet xhihadi legjitim nga ai jolegjitim, pos me dituri, nuk mund të bëhet dallimi i xhihadit të domosdoshëm nga ai vullnetar, pos me dituri, nuk mund të bëhet i ditur xhihadi kolektiv nga ai individual, pos me dituri.

¹⁷ “Miftah Dar Es-seade”, botimi i vitit 1982

Ai, i cili i shmanget diturisë dhe angazhohet me xhihad apo ibadete tjera, ka shansin të bie në mëkat ose të devijojë nga rruga e drejtë, duke mos e ditur fare. Prandaj, besimtari krahas xhihadit dhe ibadeteve tjera, duhet që të mëson deri në vdekje.

Transmetohet se Aliu r.a. ka thënë:

*“Dijetari është më me vlerë se agjëruesi, i cili përpos agjërimit falet natën, po ashtu është më i vlefshëm se muxhahidi (luftëtari në rrugën e All-llahut) ...”.*¹⁸

Sahabiu i njohur Abdull-llah Ibn Mes’udi ka thënë: *“Beto hem në Atë, që shpirti im është në dorën e Tij, do të kishin dëshiruar burrat që janë vrarë për në rrugë të All-llahut, dëshmorët, që All-llahu t’i ringjallë dijetarë kur t’i vërejnë nderimet dhe respekti që u bëhet atyre (dijetarëve)”.*¹⁹

Hasan El Basriju ka thënë:

*“Ngjyra e shkrimit e dijetarëve peshohet me gjakun e dëshmorëve. Ngjyra e shkrimit e dijetarëve peshon më tepër”.*²⁰

Përpos xhihadit me armë, kemi edhe xhihadin me gjuhë, domethënë xhihad përmes diturisë. Ky lloj i xhihadit bëhet me penë, gjuhë, sjellje dhe praktikë të mirë.

Zoti i Madhëruar në Kur’an thotë:

“Sikur të kishim dashur Ne, do të dërgonim peygamber në çdo vendbanim. Po ti mos i dëgjo jobesimtarët e luftoi ata me të (Kur’an) me një luftë të madhe”.

(El-Furkan, 51-52)

Lufta kundër tyre, me Kur’an, është luftë e madhe, ky është xhihadi më i madh.

¹⁸ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.6..

¹⁹ "Miftah Dar Es-seade", f.121

²⁰ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.5..

Nga kjo që u cek më lartë, kuptuam se kërkuesi i diturisë është në shkallë më të lartë se adhuruesi i devotshëm. Këtë e argumenton hadithi që e transmeton Ebu Derdan:

... ..
“.....Vlera e dijetarit ndaj robit (ibadetgjijt) të devotshëm është sikur që është vlera e hënës (shkëlqimi i saj) ndaj yjeve (planetëve) tjera”²¹

2. QORTIMI I INJORANCËS DHE I TË PADITURVE

Pasi që urdhri i parë në Kur'an (në islam) është urdhër për dituri, atëherë nuk vlen të pretendojë për islam i padituri, ai i cili nuk lexon e nuk mëson.

Ata, të cilët lexojnë, mësojnë, veprojnë, studiojnë dhe ngriten në kulturë, janë më afër thelbit të islamit dhe esencës së Kur'anit, se ata analfabetë e përtacë, të cilët përkundër mundësive, iu pëlqen të jetojnë në errësirë.

Paraqitja e injorancës dhe zhdukja e diturisë janë nga shenjat e Kijametit.

Transmetohet nga Enesi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Shenjat e Kijametit janë: çrrënjësja (zhdukja) e diturisë, jetësimi i mosdijes, pirja e alkoolit dhe prostitucioni”.²²

²¹ "Sunen Ebu Davud", vëll.3, fq.317, nr. h. 3641, Darul Fikri.

²² "Fet'hul Bari", vëll.I, fq. 239, nr.80.

Të paditurit dhe të paaftët nuk duhet të vihen në pozita udhëheqëse dhe të rëndësishme të shoqërisë, ngase injoranca është shenjë e dobësimit dhe shkatërrimit të një populli. Mosdija është armiku më i madh i njeriut.

Transmetohet nga Abdull-llah b. Amr b. El-Asi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“All-llahu nuk do ta zhdukë dijen me heqjen e saj nga përdorimi , por shkëncën (dijen), sigurisht, do ta heqë me zhdukjen e dijetarëve . Dhe, kur nuk do të ketë dijetarë , njerëzit do ti zgjedhin për kryetarë të paditurit . Populli do t’i pyes . E ,ata do të japin shpjegime (fetva) pa ndonjë dijeni . Ashtu ata , edhe vetë do të bien në shkatërrim e edhe të tjerët do t’i devijojnë“.*²³

Ndër shkaqet që ndikuan që muslimanët të dobësohen dhe të jenë në gjendjen, në të cilën janë sot, pa dyshim është injoranca. Po ashtu përhapja e sekteve të devijuara në mesin e muslimanëve, nuk janë shkak tjetër, përpos mos prezenca e diturisë fetare në mesin e popullatës Islame.

Ebu Dardai ka thënë:

*“Bëhu një nga këta tre: Bëhu kërkues i dijes (dijetar), ose mësues, ose dëgjues, e mos u bën i katërti e të shkatërroresh”.*²⁴

Ebu Hurejra r.a. thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë :

²³ "Sahihul Muslim", vëll.IV, fq.2058, nr.2673, Bejrut.

²⁴ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.8.

*Bota është e mallkuar dhe çdo gjë e saj është e mallkuar , përveç të përmendurit e All-llahut dhe vepra që e pason, dhe njeriut të ditur dhe atij që mëson”!*²⁵

Të qëndruarit në rrethin e të paditurve mund të ketë pasoja , dhe të dëmtohet imani dhe morali i besimtarit, andaj nga veprat e mira bën pjesë edhe largimi nga të paditurit. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.()

“Trego mëshirë dhe urdhëro mirësinë dhe largohu prej të paditurve”.

(El-A'rafë ,199)

Pra, besimtari analfabet , përtac , kur i ka të gjitha kushtet e volitshme për arsim, është kundër thënieve të para të librit të tij të shenjtë , kundër fesë së tij , ngase ai nuk lexon e nuk mëson. Në vend të diturisë dhe punës te ai gjendet padituria dhe përtacia. Një fjalë e urtë arabe thotë:

“Çdo gjë është një send , injoranca (padituria) s’është kurrnjë send”.

²⁵ "Sunen Et-Tirmidhij", vëll.IV, fq.561, nr.2322.

3. DITURIA I LARTËSON DIJETARËT MBI TË TJERËT

Kur'ani dhe hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. e lartësuan diturinë dhe dijetarët në një shkallë të lartë, saqë asnjë ideologji, në asnjë periudhë historike , të vjetër apo të re , nuk arriti t'i lartësojë ashtu. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“...All-llahu i ngre në shkallë të lartë ata të cilët besojnë në mesin tuaj dhe ata të cilëve u është dhënë dijenia. All-llahu di se çka punoni ju “. (El-Muxhadele,11)

Ibni Abbasi r.a. ka thënë:

*“Dijetarët janë të lartësuar shtatëqind shkallë mbi besimtarët, ndërsa distanca mes dy shkallëve është, pesëqind vite udhëtim”.*²⁶

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

...

*“...Për dijetarët bëjnë dua (lutje) gjithçka në qiej dhe në tokë, bile edhe peshqit në ujë. Përparësia e dijetarëve ndaj të tjerëve është sikur shkëlqimi i hënës së plotë në krahasim me të yjeve,....”*²⁷

Nga ky hadith, së pari nxjerrim parimin, se dituria i lartëson dijetarët mbi të tjerët, dhe njëherazi shkakton që ata të jenë të dashur dhe të nderuar, si nga njerëzit ashtu edhe nga gjallesat e tjera.

²⁶ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.5..

²⁷ "Sunen Ebi Davud", vëll.III, fq.317, h.3641. Këtë hadith e shënojnë edhe Tirmidhiu, Ibn Maxheh nga Ebu Darda dhe thotë Ibn Hibani e konfirmon hadith të saktë.

Në hadith gjithashtu kuptohet përparësia e dijetarit ndaj të tjerëve, prandaj kërkohet respekti dhe nderimi ndaj dijetarëve ngase ata kanë përparësi nga të tjerët. Transmetohet nga Ebu Musa El-Eshariu se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Nuk ka dyshim se prej çështjeve me të cilat nderohet Allahu është: Nderimi i atij, i cili është thinjur për shkak të islamit, nderimi i atij, i cili e mëson dhe ua mëson të tjerëve Kur’anit, nderimi i atij, i cili as nuk e tepron, por as nuk le pas dore çështjet, por islamit i përmbahet me seriozitet, dhe nderimi i kryetarit të drejtë”.*²⁸

Pra, madhërim i All-llahut qenka nderimi i dijetarit.

Vdekja e një njeriu është më pak tragjike se sa vdekja e një dijetari.

Transmetohet se Xhabiri r.a. ka thënë:

()
: (:)

*“Pejgamberi s.a.v.s. i varroste nga dy veta në Uhud, pastaj pyeste: Kush di më shumë Kur’an?, nëse tregonin nga ndonjëri, atij i jepte përparësi në varr”.*²⁹

Nëse këtë post e ka pasur i dituri pasi që ka vdekur, atëherë shtrohet pyetja se cilin post duhet ta ketë kur ai është gjallë.

²⁸ "Sunen Ebi Davud", vëll.IV, fq.261, nr.4843.

²⁹ "Sahihul Buhari", vëll.I, fq.454, nr.1288, botimi i dytë 1987, Bejrut.

Ibn Haxher El Askalani në librin e tij “Fet’hul Bari” thotë se Rebia ka thënë :

*“Nuk guxon të zhduket (të humbet) ai që ka sadopak dituri”.*³⁰

Pra, nëse ai, i cili ka sado pak dituri nuk guxojnë ta zhdukin, atëherë bëhet pyetja, a guxojnë atë, i cili ka shumë dituri ta zhdukin?!

Këtë temë “Dituria i lartëson dijetarët mbi të tjerët” në vijim do ta shtjellojmë përmes disa nëntitujve:

a) Menjëherë pas melekëve me gradë janë dijetarët e drejtë

Islami kurrë nuk ka qenë pengesë e progresit dhe shkencës . Ai i çmon aktivitetet intelektuale të njeriut gjer në atë shkallë, sa që i ve në një shkallë me melekët .

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij , e dëshmuar edhe engjujt e dijetarët , dhe se Ai është zbatuesi i drejtësisë...” (Ali-Imran , 18)

Në këtë ajet All-llahu i Madhëruar i lavdëroi melekët për gradat e tyre dhe pas melekëve përmendi dijetarët , duke i marrë ata si dëshmitarë, të cilët pranojnë njëshmërinë e Tij.

³⁰ "Fet’hul Bari", vëll.I, fq.239.

b) Dijetarët janë pas pejgamberëve

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

(... ..)

“...e sikur t’ia linin atë (përhapjen e lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ...”. (En-Nisa, 83)

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

...

*“...Vërtetë dijetarët janë trashëgimtar të pejgamberëve ; pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinarë e dërhëmë, ata vërtet kanë lënë për trashëgimi dijen , prandaj kush e merr , e ka marrë masën e mjaftueshme”.*³¹

Nga hadithi kuptojmë se dijetarët janë ata, të cilët vijnë dhe dëgjohen pas pejgamberëve, ngase ata janë trashëgimtarë të tyre. Pra, dijetarët janë ata, të cilët i prinë popullit, kurse populli i pason ata, përderisa dijetarët janë pasuesit e Pejgamberit s.a.v.s.

Në një rast pasi që Pejgamberi s.a.v.s. i drejtoi safat transmetohet nga Ebi Mes’ud Ukbe Ibn Amr El -Bedrij El-Ensarij r.a., se Pejgamberi s.a.v.s., ka thënë:

...

*“...Le të më pasojnë (afrohen) mua të mençurit dhe më të aftit , pastaj ata që vijnë pas tyre , pastaj ata që vijnë pas tyre “.*³²

³¹ "Sunen Et-Tirmidhij", vëll.V, fq.48, nr.2682.

³² "Sahihul Muslim", vëll.I, fq.323, nr.432.

Dijetari i nderuar Is-hak ibn Abdullahi ka thënë:

“ Më të afërmit e njerëzve më grada te pejgamberët janë dijetarët dhe luftëtarët , për arsye se dijetarët i udhëzojnë njerëzit në atë, që u është shpallur pejgamberëve, kurse luftëtarët me shpatat (armët) e tyre luftojnë për ta mbrojtur atë, që i është zbritur pejgamberëve”.³³

Në përmbledhjen e Taberaniut në El Evset citohet:

“Kujt i vjen vdekja duke kërkuar diturinë, ai do ta takojë Zotin, ndërsa diferenca në mes tij dhe pejgamberëve në xhennet ka me qenë vetëm grada e Pejgamberisë”.³⁴

c) Detyrë e të paditurit është të pasojë të diturin edhe nëse i dituri është më i ri se ai

Në Kur'an tregohen fjalët e Ibrahimit a.s. drejtuar babait të tij:

.()

“ O babai im , mua më është dhënë nga dituria çka ty nuk të është dhënë, andaj më dëgjo se unë të udhëzoj në rrugë të drejtë”. (Merjem ,43)

Ibrahimi a.s., edhe pse ishte djalë i ri, ai ishte në rrugën e vërtetë dhe më i ditur, prandaj ishte detyrë e babait të tij që ta pasojë të birin e tij.

³³ “El-fekih we El-Muhfekih” El-Hatib El-Bagdadi, vëll.I, fq.35. Transmeton El Hatib El Bagdadi me zingjirin e tij nga Is-hak ibn Abdullahi.

³⁴ "El-Mu'xhemul-Evset", vëll.IX, fq.174, nr.9454.

Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“ I prinë popullit (bëhet imam) ai i cili e lexon Kur'anin më së miri. E nëse janë në lexim të njëjtë , më i dituri prej tyre për sunnetin e Pejgamberit s.a.v.s.. E nëse janë në sunnet po ashtu të njëjtë, atëherë iu prinë ai i cili e ka pranuar më herët islamin prej tyre apo më i moshuari ndër ta”.*³⁵

Sipas hadithit shihet se ai, i cili ka dituri është më me vlerë dhe ka përparësi prej atij i cili është më i moshuar.

d) Pejgamberët kërkojnë dituri edhe te ata që janë nën ta me gradë

Transmetohet nga Ubejj bin Ka'bi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

: :

...

Pejgamberi Musa , duke u mbajtur fjalim Beni Israilëve , i është shtruar pyetja:

“ Kush është më i dijsلمي? Ai u përgjigj : “Unë jam më i dijsلمي”. All-llahu i Madhëruar e qortoi (për këtë) se atë njohuri nuk ia la atij, prandaj i shpalli :

*“Është një rob nga robërit e Mi aty ku vendtakohen dy detet, ai është më i ditur se ti “.*³⁶

³⁵ Transmeton Tirmidhiu h. 235.

³⁶ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.294, nr.122.

Në rrëfimin për Musain a.s., All-llahu i lartësuar thotë:

()

**Atij (Hidrit-njeriut të mirë e të dijshtëm) Musai i tha:
"A pranon të vij me ty , që të më mësosh nga ajo që je i
mësuar (i dhuruar) ti; dituri të drejtë e të vërtetë ?"**

(El-Kehf, 65-66)

Musai a.s. ishte , pa dyshim, njeriu më i mirë i kohës së vet, dhe se Hidri nuk ishte në gradën e Musait a.s. i cili ishte Pejgamber, mirëpo Musa a.s. dëshironte që ta shoqëronte Hidrin me qëllim që të mësonte nga ai.

e) Nganjëherë ai që është në gradë më të ulët mund t'i afrohet diturisë më shumë se ai që është në gradë më të lartë

Kjo vërehet në rrëfimin Kur'anor për shpendin me emrin Hud'hud. Kur Sulejmani s.a.v.s. vendosi që ta ndëshkojë Hud'hudin që nuk ishte prezent , me ç'rast ai kthehet duke ia sjellë lajmin vijues:

.(...)

"... Unë kuptova atë që ti nuk je i njoftuar dhe të erdha nga Sebei me një lajm të sigurt ". (En-Neml, 22)

Po ashtu , në rrëfimet për bijtë e Ademit a.s., ku njeriu mësoi prej sorrës:

“All-llahu dërgoi një sorrë, e cila groponte në dhe , për t’i treguar atij se si ta mbulojë trupin e të vëllait , e ai tha : I mjeri unë , a nuk qesh i aftë të bëhem si kjo sorrë , e ta mbuloja trupin e vëllait tim ? ashtu mbeti i penduar”.

(El-Maide , 31)

Nga e gjithë kjo kuptojmë se dituria i lartëson dijetarët mbi të tjerët dhe se njerëzit janë të varfër nga aspekti i diturisë, andaj ai duhet gjatë gjithë jetës të vazhdon me kërkimin e saj.

KAPITULLI I DYTË

II

APELIMI I KUR'ANIT DHE I HADITHEVE PËR HULUMTIM, STUDIM DHE SPECIALIZIM

- KËRKIMI I DITURISË RRUGA PËR NË XHENNET
- UDHËTIMI PËR KËRKIMIN E DITURISË
- SHOQËRIMI ME TË DITURIT
- KËSHILLIMI ME TË DITURIT
- DITURIA NUK KA KUFIJ
- VLERA E LEXIMIT TË KUR'ANIT,
HADITHEVE TË PEJGAMBERIT s.a.v.s. DHE
E DICIPLINAVE TË TJERA SHKENCORE
- SHEJTANI PENGESË NË KËRKIMIN E
DITURISË

APELIMI I KUR'ANIT DHE I HADITHEVE **PËR HULUMTIM, STUDIM DHE** **SPECIALIZIM**

All-llahu i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“...dhe thuaj o Zot ma shto diturinë!” (Ta ha, 114)

Ky ajet vë theksin se Muhamedi a.s. e lakmonte diturinë më shumë se pasurinë. Ai kërkonte gjithnjë t'i shtohet dijenia dhe përpiquej gjithnjë t'i shtohet rrethi i të diturve.

Këtë e dëshmon ngjarja që ka ndodhur pas Luftës së Bedrit, kur Pejgamberi s.a.v.s. me muslimanët i kishin zënë shtatëdhjetë robër. Pejgamberi s.a.v.s. ua kishte kushtëzuar atyre lirim nga robëria, që secili prej tyre dhjetë fëmijëve musliman t'ua mësojë shkrim-leximin.³⁷

Detyrë e rinisë është që ajo të armatohet me dituri, të jep mundin e vet në specializimin e profesionit të tij. Akoma në shumë vende islame dominon analfabetizmi, dhe ende disa njerëz mendojnë se shkak i prapambeturisë është islami . Por, kjo asesi nuk është e vërtetë.

Në kohën kur muslimanët zbatuan urdhrat e Kur'anit , si ajetin e parë, që zbriti ,

.()

“Lexo (mëso, studio)...” (El-Alak,1), atëherë muslimanët ishin në kulminacion të civilizimit. Civilizimi i tyre e udhëhoqi botën përafërsisht dhjetë shekuj. Gjuha arabe ishte

³⁷ Shiko transmetimin e Ibni Sa'di-t nga Amër Esh-Sh'abiu, “Tabekatu Ibn Sa'd”, vëll.I, fq.22, botimi i Bejrutit.

gjuha e shkencës , Evropa mësonte prej tyre , mësonte në shkollat dhe universitet e tyre. Ne duhet të kthehemi ashtu siç kemi qenë , e kjo nuk mund të realizohet pa e përvetësuar shkencën (diturinë) dhe atë në të gjitha fushat shkencore .

Çdo lëvizje islame, e cila vepron sot për ngjalljen e islamit në mesin e muslimanëve, ata patjetër duhet të pajisen me dituri. Andaj, qëndron rregulli i fikhut (Kaide Fikhije):

*“Çdo çështje, pa të cilën vaxhibi nuk plotësohet përveç se me të, atëherë edhe vet çështja, e cila e plotëson atë është obligative (vaxhib)”.*³⁸

Në hadithin e Pejgamberit a.s. thuhet:

*“Kërkitimi i diturisë është detyrë e secilit muslimanë”.*³⁹

Islami diturinë e ndanë në dy pjesë:

- 1) **Farzi ajn**, që do të thotë diturinë të cilën e ka obligim që ta mëson çdo njëri personalisht, p.sh., çështja e besimit; kush është Zoti i tij? si falet namazi dhe si priset? etj.. Kjo kërkohet nga çdonjëri dhe se besimtari do të përgjigjet për to.⁴⁰
- 2) **Farzi kifaje**, është ai obligim, të cilin nëse e kryejnë një grup i muslimanëve, atëherë muslimanët e tjerë lirohen prej atij obligimi, p.sh. mësimi i medicinës, gjeografisë

³⁸ “Sherh El-Kavaid El-Fikhije”, Ahmed bin esh-shejh Muhamed Ezzerka, fq.486, botimi i dytë, 1989 Damask.

³⁹ "Sunen Ibni Maxheh", Muhamed bin Jezid Ebu Abdullah El-Kazvini, vëll.I, fq.81, nr.224, Bejrut.

⁴⁰ Për më tepër shiko: "Ihja Ulumud din", vëll. I, fq.56

dhe shkencave tjera. Nëse askush nga muslimanët nuk i mëson këto shkenca, atëherë të gjithë banorët e atij vendi janë mëkatarë.⁴¹

Ajetet dhe hadithet që nxisin besimtarin për ta kërkuar diturinë, për studim e hulumtim, janë të shumta. Prandaj, këtë temë “*Apelimi i Haditheve për hulumtim, studim dhe specializim*” në vazhdim do ta shtjellojmë në disa nëntituj:

1. Kërkimi i diturisë rruga për në Xhennet

Nëse ke kërkuar dituri, atëherë i ke kërkuar të gjitha, pasi që dihet se dituria është themeli i çdo çështjeje, e cila ndërlihet me jetën e njeriut.

Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë:

...

*“Kush nisat në rrugë që të kërkojë dituri, All-llahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhennet”.*⁴²

Nga hadithi mësojmë se rruga për kërkimin e diturisë është ajo, e cila shkakton që All-llahu i Madhëruar t’ia lehtësojë besimtarit në arritjen e pikësnyimit më të lartë, e ajo është arritja e kënaqësisë së All-llahut, shpërblimi i të cilit është përfundimi më i mirë në xhennet, ku do të qëndrojë përgjithmonë.

Ulja në tubimet e kërkimit të dijes, është një kopsht i xhenetit, siç ceket në hadithin, të cilin e transmeton Ibni Abbasi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

⁴¹ Për më tepër shiko: "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.59

⁴² "Sunen Et-Tirmidhij", vëll.V, fq.48, nr.2682.

:

:

“Kur të ftoheni për të shkuar në bashqet e xhenetit shkroni e mos ngurroni. E pytën të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s.: Po ku janë bashqet e xhenetit? Pejgamberi s.a.v.s. tha: Vendtubimet e diturisë”.⁴³

Ndër veprat më të mira pas besimit (islamit), është kërkimi i diturisë, prandaj besimtari duhet të vazhdojë në kërkimin e saj deri në vdekje.

Transmetohet nga Ebu Seid El-Hudrij r.a., se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë:

“Dijetari nuk ngopet me dituri, derisa nuk përfundon në Xhennet”.⁴⁴

Që do të thotë se besimtari duhet të vazhdojë me të mira, sidomos në kërkimin e diturisë duke pasur parasysh se njeriu në mizanin e Ditës së Gjykimit mund të jetë peng i një vepre të mirë, që të shpëtojë në xhenet apo të hidhet në zjarr.

Në lidhje me komentimin e ajeti Kur'anor: **“...Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë ...”**, Hasan El Basriju ka thënë: *“E mira e kësaj bote është dituria dhe ibadeti”*, kurse për pjesën tjetër të ajetit: **“... dhe të mira edhe në botën tjetër ...”**, (El Bekare, 201) ai thotë: *“ e mira e botës tjetër është xhenneti”*.⁴⁵

⁴³ " El Kebir ", Taberani vëll.XI, fq. 95, nr.11158, botimi i dytë 1983, Mosul.

⁴⁴ "Musned Esh-Shihab", Muhamed bin Selmete bin Xha'fer Ebu Abdull-llah El-Kuda'ij, vëll.II, fq.68, nr.897, botimi i dytë 1986, Bejrut.

⁴⁵ "Miftah Es-seade", vëll. I, fq. 77

2. Udhëtimi për kërkimin e diturisë

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“Thuaj , udhëtoni nëpër tokë e shikoni se si filloi krijimi , ...”

(El Ankebutë,19)

Do të thotë, udhëtoni dhe atë që e përjetoni , ato krijesa , sende që i shihni studioni , vëreni harmoninë e pashembullt , e cila mbretëron mes qenieve e sendeve në ekzistencë. Pastaj ajeti:

()

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë , dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë?....”

(El-Haxh ,46)

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Kush niset në rrugë me qëllim që të kërkojë dituri, ai është në rrugën e All-llahut deri sa të mos kthehet nga ajo rrugë”.⁴⁶

Nga hadithi kuptojmë se udhëtimi për kërkimin e diturisë është ibadet.

Ai, i cili mësyn rrugën për kërkimin e diturisë është në kënaqësinë e All-llahut dhe njëherit gjithçka për rreth tij bën lutje për të, ndërsa melaqet e rrethojnë të kënaqura me veprën e tij të mirë.

⁴⁶ "Sunen Et-Tirmidhij", vëll.V, fq.29, nr.2647. Tirmidhiu thotë se ky është hadith hasen.

Transmetohet nga Safvan B. Asal El-Meradi r.a., se me një rast ka shkuar te Pejgamberi s.a.v.s., i cili ishte ulur në xhami dhe i është drejtuar :

“O Pejgamber i All-llahut , kam ardhur për të kërkuar dituri”, ai përgjigjet : “Mirë se vjen o gjurmues i diturisë, vërtetë atë që kërkon dituri e rrethojnë melaqet dhe i bëjnë hije me krahët e tyre , pastaj diçka ngriten dhe udhëtojnë derisa arrijnë në qiellin e kësaj bote , duke u gëzuar për kërkimin e tij të diturisë”.⁴⁷

Shembull për udhëtim në kërkimin e dijes kemi gjeneratat e para të muslimanëve. Ata kanë bërë udhëtime të largëta për lypjen e diturisë, sjelljeve , virtyteve nga dijetarët e shquar të asaj kohe.

Ibn Haxher El Askalani thotë se *Xhabir B. Abdull-llahu ka bërë një udhëtim një muajsh në këmbë , për te Abdull-llah B. Unejsi , vetëm për të mësuar një hadith.*⁴⁸

⁴⁷ "El Kebir", vëll.VIII, fq.54, nr.7347.

⁴⁸ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.234.

3. Shoqërimi me të diturit

Secili njeri ndikohet nga shoqëruesi i tij. Ai që shoqërohet me njerëz të thjeshtë dhe pleq , prej tyre fiton shumë gjëra nga përvoja, ai që shoqërohet me intelektualë dhe mendimtarë , nuk është i barabartë me atë që shoqërohet me masën e gjerë. Transmetohet nga Ebu Musa El-Esh'arij r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë :

{ } .

*“Shembulli i ndejës me njerëz të mirë dhe ndejës me njerëz të këqij është sikurse shitëtorja e miskut (parfumeria) dhe farkëtorja. Shitësi i miskut ose të jep (të erosë) ose të shet , ose së paku prej tij kundërmon erë e këndshme . Kurse farkëtari ose t'i djeg teshat , ose prej tij do të vjen erë e pakëndshme (nga thëngjilli)”.*⁴⁹

Nga hadithi kuptojmë se njeriu duhet zgjedhur vetvetes për shoqërim ata që i bëjnë dobi dhe ia shtojnë dijen . Le të kujdeset të bëjë lidhje me miqtë e librit , duke caktuar një ndejë të veçantë, ku do të shpalosin atë që kanë lexuar dhe të përcjellin gjërat e reja. Gjithashtu edhe Llukmani a.s., e ka këshilluar birin e tij: *“O biri im të këshilloj të shoqërohesh me të diturit dhe të dëgjosh fjalët e të urtëve , sepse All-llahu e ngjallë zemrën e vdekur me dritën e urtësisë, mu sikurse shiu, i cili vitalizon tokën e tharë”.*⁵⁰

⁴⁹ "Sahihul Buharij", vëll.V, fq.2104, nr.5214, botimi i tretë 1987, Bejrut.

⁵⁰ "El Kebir", vëll.XIII, fq.236.

4. Këshillimi me të diturit

Për problemet jetësore, pengesat e ndryshme dhe për gjërat e pakuptueshme, kërkohet që besimtari të këshillohet me dijetarët. Prandaj, është thënë: Ilaçi i paditurisë (xhehlit) është të pyeturit. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

” Për këtë pyete ndonjë shumë të dijsëm “.

(El - Furkan, 59)

Në çështje fetare pyetet dijetari përkatës, në çështjet luftarake duhet ndalur në mendimin e ekspertëve ushtarakë, në ekonomi merret mendimi i ekonomistëve etj.

Sahabët kanë qenë shumë të interesuar që ta pyesin Pejgamberin s.a.v.s. për problemet e paqarta.

() :

...

Transmetohet nga Abdull-llah b. Amr b. Al-Asi , i cili ka treguar se Pejgamberi s.a.v.s. gjatë Haxhit Lamtumirës ka mbetur në Mine për shkak të njerëzve të cilët i kanë parashtruar pyetje .⁵¹

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“... Ju (idhujtarë) pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini”.

(El-Nahl , 43)

Pra rekomandohet të pyetet eksperti për gjërat e paqarta, me qëllim që të mos mbetemi të paditur (xhahil).

⁵¹ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.243 nr.83.

5. Dituria nuk ka kufij

Detyrë e besimtarëve është që të armatosen me dituri dhe kulturë, t'ua tejkalojnë të gjithëve në profesionin e vet, ta jap mundin e vet në kërkimin e diturisë, ta kërkojmë diturinë prej djepit deri në varr, ngase dija është det pa brigje dhe pa fund.

Në ngjarjen e Musait a.s. dhe Hidrit, kur ata ishin duke udhëtuar me anije, erdhi një shpend, u lëshua në buzë të anijes dhe me sqepin e tij i shpoi një ose dy vrima. Hidri tha:

*"O Musa, dijenia ime dhe e jotja, në krahasim me dijeninë e Allahut është e vogël, sa vrima e këtij zogu ndaj detit".*⁵²

Besimtari duhet të vazhdon me kërkimin e diturisë, ngase aq më shumë që zgjerohet ishulli i njohurive, aq më tepër zgjerohet deti i sekreteve.

Kurse të vërtetën e ka thënë All-llahu në ajetin Kur'anor.

.()

"... E juve ju është dhënë fort pak dije "

(El-Israë, 85)

Besimtari nuk duhet të bëhet kryelartë me atë që e ka mësuar, dhe nuk duhet të ndihet në vete si i madh e të thotë se ka arritur shumë. Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*"Kush thotë unë jam më i dituri, ai është i paditur (injanor)!"*⁵³

⁵² "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.295 nr.122.

⁵³ "El-Mu'xhemul Evset ", vëll.VII, fq.59, nr.6846.

Ndërsa Ibni Mubareku ka thënë:

*“Njeriu nuk ndalet nga kërkimi i diturisë, përderisa ai thotë se e ka tubuar tërë diturinë, (e nëse mendon kështu) atëherë ai është bërë injorant”.*⁵⁴

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.()

“...Atë që duam Ne e lartësojmë shumë në dituri, e mbi secilin të dijshtëm ka edhe më të dijshtëm”. (*Jusuf, 76*)

Besimtari duhet të lus Zotin e Madhëruar me lutjen:

O Zoti im më bënë të vogël në vete dhe të madh tek Ti.

6. Dituria armë e fortë kundër shejtanit

Besimtari duhet të mëson dhe të armatoset me dituri, sepse në të kundërtën shumë lehtë mundet të bie në grackat (kurthet), të cilat i përgatit shejtani i mallkuar. Prandaj, dituria është fortifikatë dhe mënyra më e mirë për mbrojtje nga shejtanët e mallkuar.

a). Shejtani pengesë në kërkimin e diturisë së dobishme

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Një i ditur (fakih) i vetëm është më i fuqishëm në luftë kundër shejtanit, sesa një mijë abid (adhurues)”.*⁵⁵ Nëse bëhet pyetja si?, atëherë përgjigjen e gjejmë në tregimin të cilin e transmeton Ibni Abbasi r.a., i cili thotë:

⁵⁴ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.52.

⁵⁵ "Sunen Ibni Maxheh", vëll.I, fq.81, nr. 222.

Shejtanët i thanë Iblisit: "Sunduesi jonë, ne i gëzohemi vdekjes së dijetarit shumë më shumë se vdekjes së abidit (robër të Allahut xh.sh.), sepse dijetari na përgatit kurthe të shumta, e abidi jo. Iblisi tha: E jani me mua! Erdhën deri te një abid dhe e gjetën në namaz. Iblisi tha: Dëshirojmë diçka të të pyesim: A është sunduesi yt në gjendje ta krijojë botën në lëvore të vezës? Abidi u përgjigj: Nuk e di! Atëherë Iblisi u tha shejtanëve. A e patë kufirin (mosbesimin) në përgjigjen e tij?! Pastaj Iblisi me vëllezërit e tij erdhi te dijetari të cilin e gjetën duke bërë shaka në praninë e shokëve të tij dhe i thanë: Dëshirojmë diçka të të pyesim! Dijetari u përgjigj: Pyetni!

Iblisi i tha: A është Sunduesi yt në gjendje ta krijojë botën në lëvore të vezës? Po – u përgjigj dijetari. Si! – pyeti Iblisi. Dijetari lexoi ajetin që vijon:

“Kur Ai dëshiron ndonjë send urdhri i Tij është vetëm t’i thotë: ‘Bëhu’! ai menjëherë bëhet” . (Jasin, 82)

Pas kësaj Iblisi u tha shejtanëve:

- *A e patë se sa është dallimi në mes abidit dhe dijetarit?!*

Abidi nuk i bën padrejtësi as vetes as të tjerëve, por dijetari krahas saj me diturinë e vet të madhe më nënçmon mua”.⁵⁶

Nga ky tregim kuptojmë se shejtani u përgatitë kurthe besimtarëve, njëherit e vendosë një "bidat (risi)" në fe, e sheh atë dijetari dhe ndalon prej tij , kurse robi është i përqendruar në adhurim dhe nuk e vëren atë.

Është e vërtetë se atë çka punon (përgatit) shejtani, ndoshta me muaj e me vite dijetari e vëren, e lufton dhe e shkatërron atë të keqe. Nuk ka diç më të vështirë për Iblisin se sa mbetja e një dijetari në një popull.

⁵⁶ “Xhinët mbrojtja dhe shërimi me Kur’an dhe Sunnet”, Ali Tahiri, fq.103-104, botuar më 1999, në Kamjan, Tetovë.

Transmetohet nga Ebi Dardai se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

...

*“Vdekja e dijetarit është fatkeqësi e pakompenzuar dhe zbrazëti e cila nuk mbulohet, yll i cili shuhet e nuk shkëlqen. Më e mirë është vdekja e një fisi se sa vdekja e një dijetari”.*⁵⁷

b). Shejtani nxitës në kërkimin e diturisë së padobishme (të dëmshme)

Nga ajo që u tha më lartë, kuptuam se shejtani është pengesë e kërkimit të diturisë së dobishme, ndërsa duhet pasur parasysh se shejtani është edhe nxitës për kërkimin e diturisë së dëmshme. Nga Zejd Ibn Erkam transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. na ka mësuar që ta lusim Zotin:

...

*“O Zot, kërkoj mbështetje te Ti nga dituria që nuk ka dobi...”*⁵⁸

- Es-Sihru (magjia) është një prej metodave, me të cilat shejtani humb njerëzit, ata u mësojnë atyre këtë dituri, e cila bën vetëm dëm e nuk bën dobi dhe është rrugë për ndarjen në mes të burrit dhe gruas e që është pikësynimi i shejtanit të mallkuar.

All-llahu i Madhëruar në Kur'an na tregon:

)

.(...

⁵⁷ "Mexhmeuz-Zevaid", vëll.I, fq.202, nr. 2682

⁵⁸ "Sahihul Muslim", vëll.4, fq.2088, nr. 2722.

“(E hodhën librin e Zotit) e ndoqën atë që e thonin shejtanët në kohën e sundimit të Sulejmanit . Po Sulejmani nuk ishte pabesimtar , por shejtanët ishin të tillë , sepse mësonin njerëzve magjinë...” (El –Bekare , 102)

Pra, shejtanët ishin ata, të cilët i mësonin njerëzit, por mësimi i tyre ishte i dëmshëm.

- E ardhmja është fshehtësi e All-llahut , andaj kërkimi i diturisë, gjoja për ardhmërinë është një derë në krye të së cilës qëndron shejtani i mallkuar. Islami i zhduki tentimet e njohjes së ardhmërisë përmes fallit dhe horoskopit, sepse shtizat e shigjetat nuk e dinë se ku është e mira , prandaj kërkimi i diturisë nga ato është prishje e mendjes dhe nxitje nga djalli i mallkuar.

E ardhmja është fshehtësi e All-llahut të Madhëruar , për këtë arsye , i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., na mësoi Salat-ul-Istiharen (namazi i zgjedhjes), kur dëshirojmë të udhëtojmë, të martohemi , të blejmë ndonjë send me vlerë etj., me qëllim që All-llahu i Madhëruar të na udhëzojë në atë që është më e mirë për ne .

- Ndodh që njeriu ta kërkon diturinë , ta mësojë sheriatin dhe të jetë larg nga All-llahu i Madhëruar, ngase mësimin e shariatit e përdor në ndjekjen e epshit , epshin e vet apo të tjetrit , disa herë përmes kënaqjes së pushtetmbajtësve , e disa herë përmes kënaqjes së masave të gjëra popullore. Me këtë sjellje dituria do të jetë dënim për të, dhe kjo është dituria, e cila nuk sjell dobi. Prandaj besimtari duhet të kërkojë nga Zoti i Madhëruar dituri të dobishme, ashtu siç na mësoi Pejgamberi s.a.v.s.:

“O Zoti im unë të lutem që të më dhurosh dituri të dobishme, furnizim të begatshëm dhe të lutem të m’i pranosh veprat e mijja”.⁵⁹

⁵⁹ "Sunen Ibni Maxhe", vëll.I, fq.298, nr.925.

7. Vlera e leximit të Kur'anit, haditheve të Pejgamberit s.a.v.s., dhe disiplinave të tjera shkencore

a) Vlera e leximit të Kur'anit

Islami e çmon çdo degë të diturisë, sidomos shkencat islame juridike , sepse ato ndikojnë më shumë te njerëzit që t'i kryejnë detyrat e All-llahut xh.sh., ndaj vetes dhe ndaj shoqërisë, me një përgjegjësi më të madhe.

Transmeton Muaviu r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“ Atij që All-llahu ia do të mirën , e udhëzon t'i kuptojë parimet e fesë, ... ”*⁶⁰

S'ka dyshim se leximi më i preferuar, më i dobishmi e që më së shumti njerëzit kanë nevojë, është leximi i librit të All-llahut të Madhëruar-Kur'ani. Në të gjendet programi i jetës së njeriut në këtë botë, lumturia dhe shpëtimi i tij në këtë dhe në botën tjetër, ndërsa lënia pas dore e kësaj diturie është humbje dhe shkatërrim:

“Aliu r.a ka përmendur sprovat që do të ngjajnë në Kohën e Fundit, kurse Omeri r.a. i tha: Kur do të ndodhë kjo ? Iu përgjigj: Kur do të mësojnë njerëzit për gjëra e jo për fe, kur do të mësojnë, jo që të veprojnë dhe kur do të kërkojnë dunjanë me vepra të Ahiretit”.⁶¹

Leximi i Kur'anit besimtarit ia ngritë shkallët në xhennet dhe bën që ai të jetë posedues i pronës dhe shpërblimit të madh në te.

⁶⁰ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.221, nr.71.

⁶¹ “Sahihut –Tergibi vet-Terhibi” nga Muhammed Nasirudin Albani vëll.I, f.120, nr.106. Këtë e Transmeton Abdurr- Rrezaku në Musennefin e tij Sahih.

Transmetohet nga Ibnu Amr Ibnul Asi r.a., se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

:

*“Poseduesit të Kur’anit do t’i thuhet : Lexo dhe ngrihu lartë , lexoje ashtu si e ke lexuar në dunja. Vendi yt do të jetë te ajeti i fundit të cilin do ta lexosh”.*⁶²

Transmetohet nga Ebu Umame r.a., se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Lexojeni Kur’anin , vërtetë ai do të ndërmjetësojë Ditën e Gjyqimit për të zotët e vet “.*⁶³

Ajo që kuptojmë nga këta dy hadithe, është se dobia e leximit të Kur’anit nuk do të mungojë as në Ditën e Ringjalljes, në atë ditë kur njeriu më së shumti është i nevojshëm për vepra të mira.

b) Vlera e mësimit të haditheve të Muhammedit a.s.

Sunneti është bazë e shariatit së bashku me Kur’anin, ngase burimin e kanë të njëjtë.⁶⁴ Këtë mund ta kuptojmë nga shumë ajete, me të cilat All-llahu i Madhëruar na urdhëron për besim , nënshtrim , përgjigje e dëgjim, ndaj gjithë asaj që na vjen nga Pejgamberi s.a.v.s. All-llahu i Madhëruar në Kur’an thotë:

.(...)

⁶² "Sunen Et-Tirmidhij", vëll.V, fq.177, nr.2914. Tirmidhiu thotë: Ky është hadith hasen sahin.

⁶³ "Musned Ahmed", Ahmed bin Hanbel, vëll.V, fq.254, nr.22247, Egjipt.

⁶⁴ Me “Sunnet” nënkuptojmë fjalët, veprat dhe pëlqimet e Pejgamberit s.a.v.s.

“Kush i bindet Pejgamberit , ai i është bindur Allahut...” (En-Nisa, 80)

Sunneti është burim i besimit , dispozitave , normave morale , politike dhe ekonomike. Po ashtu suneti sqaron dhe shkoqitë atë që është e përgjithësuar në Kur’an. Pra, me hadithin-Sunnetin kemi të bëjmë me bazën , pa të cilën nuk mund të plotësohet Islami dhe të kuptohet Kur’ani.⁶⁵ Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Po ua lë dy porosi: Kur’anin dhe Sunnetin kurrë nuk do të jeni në humbje nëse veproni sipas tyre”.*⁶⁶

Nga hadithi kuptojmë se ndër leximet më të vlefshme dhe më të preferuara pas leximit të Kur’anit, është leximi mbi hadithin-sunnetin e Muhammedit s.a.v.s

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“All-llahu ia shndritë fytyrën atij njeriut që dëgjon hadithin tim, e mëson dhe e kupton e pastaj e transmeton. Ka bartës të dijes e vetë nuk dinë dhe ka të atillë që e bartin dijen te ata që janë edhe më të ditur”.*⁶⁷

Nga ky hadith kuptojmë se Pejgamberi s.a.v.s. është lutur për atë, i cili e mëson ndonjë hadith dhe pastaj të njëjtën ia transmeton të tjerëve.

⁶⁵ “Sunneti bazë e Sheriatit”, Sulejman Osmani, fq.5 , 1996 Gjilan.

⁶⁶ "Mustedrek", Hakimi në vëll.I, fq.93. Poashtu "Muvet-ta Malik", vëll.II, fq.899, nr.1594, Egjipt.

⁶⁷ "Musned Esh-Shihab", vëll.II, fq.307, nr.1421.

Interesimin për lëmin e hadithit e hasim më së shumti te sahabët r.a., ndërsa s'ka dyshim se më i frytshmi në transmetimin e haditheve ka qenë Ebu Hurejre r.a..

Transmetohet nga EbuHurejre , i cili tregon:

: ()

Është thënë: “O i dërguari i All-llahut, cili do të jetë në Ditën e Kijametit më së shumti i denjë për ndërmjetësimin (shefaatin) tënd në Ditën e Kijametit?” Pejgamberi s.a.v.s. tha: “O Ebu Hurejre, e kam ditur se para teje asnjë nuk do të më pyes për këtë çështje, sepse kam vënë re dëshirën tënde të zjarrtë për hadithe...”.⁶⁸

c) Vlera e leximit të disiplinave tjera shkencore

Me shkencë nënkuptojmë: “Ajo që bazohet në vëzhgim dhe eksperimentim dhe që i është nënshtuar masave dhe kontrollimeve”, siç janë: Fizika, kimia, biologjia, gjeologjia, astronomia, anatomia, mjekësia etj.

Leximi shkencor është shumë i rëndësishëm në këtë kohë, për të gjithë dijetarët në përgjithësi, kurse për thirrësit islam në veçanti. Në hadith thuhet:

وان النبي صلى الله عليه وسلم قال الحكمة ضالة المؤمن حيثما وجدها اخذها

“Urtësia është gjë e humbur e besimtarit , ku do që e gjen ai duhet marrë”.⁶⁹

⁶⁸ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.261 nr.99.

⁶⁹ "Musned Err-Rrujaniju", Muhamed ibn Harun Err-Rrujanij Ebu Bekr, vëll.I, fq.75, nr.33, botimi i parë 1995 Kajro. Dr. Jusuf Kardavi në librin "Err-rresul

Thirrësi, i cili di mirë të përdorë faktet shkencore në fushat, të cilat i kemi përmendur lehtë do të gjejë rrugën e shtruar, deri te mendja dhe ndjenjat e njerëzve .Të folurit e tij do të jetë i pranueshëm nga ana e intelektualëve dhe do të lënë gjurmë.

Të mësuarit e shkencave të dobishme , siç janë medicina , bujqësia , mekanika , elektroteknika , paraqesin farzin kifaje (obligimin kolektiv), të cilin nëse një grupacion nga muslimanët e kryejnë , bie përgjegjësia e kryerjes së këtij farzi nga muslimanët e tjerë. Mirëpo , nëse askush nga muslimanët nuk e kryen këtë lloj të farzit , atëherë të gjithë muslimanët janë mëkatarë. Ata që mund t’i studiojnë këta shkenca , janë të obliguar t’i mësojnë për progresin e shoqërisë islame .

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

()

“All-llahut i frikohen nga robërit e Tij vetëm dijetarët”. (Fatir ,28)

Nga ajeti i lartshënuar është e logjikshme të mendohet në dijetarë të të gjitha disiplinave shkencore të dobishme. P.sh. Astronomi, duke studiuar ligjet e lëvizjeve të trupave qiellorë, vjen në përfundim se ekziston një fuqi që i drejton ato. Biologu, duke e studiuar pëlhurën (lëvozhgën) e bimëve, të ushqyerit e tyre përmes rrënjëve, e frymëmarrjen e tyre përmes gjetheve, do të vijë në përfundim se ato i drejton një fuqi me vetëdije. Mjeku, duke u thelluar në shkencën e anatomisë, psikologjisë dhe në ligjshmëritë e tjera të organizmave të ndërlikuara të qenieve të gjalla, do të kuptojë domosdonë e ekzistencës së një qenie më të përsosur, Zotin e të gjitha krijesave .

vel Ilm" (Pejgamberi a.s. dhe Dituria) për këtë hadith thotë se senedin e ka të dobët, por kuptimin e ka të mirë.

Dijetarët e shekujve të më hershme nuk u kufizuan vetëm në studimin e një lëmie. Thuhet se kur Ibni Tejmije e ka ligjëruar një lëndë, njerëzit kanë menduar se ai nuk ka studiuar tjetër lëndë, pos kësaj, të nesërmen kur e ka ligjëruar tjetrën, thua se ai nuk ka studiuar tjetër lëndë përveç saj.

Atëherë, kur muslimanët ishin muslimanë të vërtetë dhe islami ishte atje ku duhet, muslimanët ishin populli i parë dhe bota e parë në rruzullin tokësor. Civilizimi i tyre e udhëhoqi botën përafërsisht dhjetë shekuj. Atëherë muslimanët dominonin, komandonin dhe udhëhiqnin, bota mësonte prej tyre, mësonte në shkollat dhe universitetet e tyre, gjuha arabe ishte gjuha e shkencës, kurse evropianit që dëshironte të tregohet se është intelektual, apo i përparuar fliste disa fjalë arabe, siç veprojnë shumë të rinj tanë në këtë kohë, të cilët kur flasin me ty hedhin disa fjalë angleze, me qëllim që të tregojnë se janë të përparuar dhe civilizuar.

“Ngritja dhe financimi i institucioneve arsimore e shkencore në atë kohë, bëhej drejtpërdrejtë nga Halifët (prijësi i shtetit islam). Për atë se sa e çmonin shkencën (dijen), Halifët islam dëshmon edhe fakti se Halifi Harun Err-Rrashid Haraxhin⁷⁰ e merrte në libra, kurse Halifi El-Me'mun peshën e librave të shkruara nga dijetarët e paguante me ar”.⁷¹

Aliu r.a., ka thënë: *“Dituria është gjë e humbur e besimtarit, ju merrjani atë, qoftë edhe prej duarve të idhujtarëve (pabesimtarëve)”*.⁷² Kjo më tepër mund të përdoret në rezultatet e shkencave të pastra materialiste, të cilat nuk kanë ngjyrë besimi ithtarët e saj, e as me mendimet e tyre.

⁷⁰ Haraxhi është tatimi ndaj jomuslimanit, i cili bie mallra për tregti, nga shtetet e tjera në shtetin islam.

⁷¹ "Arapsko-Islamski uticaj na Evropsku renesanca", Grup autorësh, fq. 152.

⁷² "Xhamiu Bejnel-Ilm", vëll. I. fq. 121.

Kështu që nuk ka pengesë që muslimanët t'i pranojnë-miratojnë shkencat e pastra universale (kozmiqe): mjekësinë, kiminë, fizikën, optikën, atletikën etj., prej popujve me qytetërim të vjetër, siç janë romakët, persianët e sidomos prej grekëve.

Ndërsa, nëse ka të bëjë me çështjet e besimit-fesë, do të thotë çështjet që janë të rregulluara nga ligjdhënësi-All-llahu i Madhëruar, atëherë besimtari duhet të kthehet në bazë të shëndoshë të Kur'anit dhe Sunetit. Pejgamberi s.a.v.s. Umerit r.a., nuk ia pranoi kur pa se ai lexonte diç nga fletushkat e ithtarëve të librit nga çifutët. Nga fakti se All-llahu i ka pasuruar me Kur'an të mbrojtur nga librat që pësuan devijime dhe ndryshime. Ajo që nxjerrim nga kjo ngjarje, është se Pejgamberi s.a.v.s., kur pa Umerin r.a. në këtë gjendje ishte hidhëruar, iu kishte ndryshuar ngjyra e fytyrës ngase çështja këtu ishte e fesë e ajo nuk merret përveç se nga ai që është besnik.

Truri jonë fatkeqësisht ushqehet me mbeturina të kulturave të huaja, në vend se të ushqehet me kajmakun e shkencave të huaja. Kjo është kështu ngase mungon tek ne selektimi i asaj se çka është e dobishme dhe çka nuk është e dobishme.

Etika islame , konceptet e saj mbi moralin shoqëror e individual , mbi drejtësinë , mbi lirinë, janë pamasë më të lartësuara , pa masë më të përsosura nga konceptet dhe idetë përkatëse të civilizimit perëndimor. Gjërat, të cilat muslimanët duhet t'i marrin nga civilizimi perëndimor janë shkencat ekzakte , në format e tyre të pastra , të dobishme dhe të ndershme . Ndërkaq gjërat që muslimanët duhet larguar nga kultura perëndimore janë bindjet , idetë e devijuara si dhe traditat me morale të ulëta njerëzore.

KAPITULLI I TRETË

III

DITURIA PËRGJEGJËSI DHE **SHËRBIM NDAJ MISIONIT FETAR**

- VLERA E ATIJ I CILI I MËSON TË TJERËT

- OBLIGIMET E DIJETARËVE PËR SHPËRNDARJEN E DITURISË

- NXITJA PËR PËRHAPJEN E DITURISË DHE MOSFSHEHJA E SAJ

DITURIA PËRGJEGJËSI DHE SHËRBIM NDAJ MISIONIT FETAR

Dijetarët pa dyshim janë kurora , drita , shpirti dhe truri i një populli.

Gjithmonë dhe sa herë që kjo dritë është ndriçuar populli ka qenë në famë dhe lumturi, e gjithmonë kur kjo dritë është shuar , popullit iu është kërcënuar injoranca, dobësia dhe shkatërimi.

Gjatë zhvillimit historik të muslimanëve, vërejmë se ata kishin nevojë për dijetarë, por edhe në të ardhmen do të kenë nevojë për dijetarë, të cilët do t'i shërbejnë misionit fetar. Transmetohet nga Ebu Hurerja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Me të vërtetë All-llahu këtij ummeti në fillim të çdo shekulli do t'i dërgojë ndokënd (dijetarë) që tua mësojë fenë!”⁷³

Transmetimi i diturisë te të tjerët , përkujtimi i ajeteve dhe haditheve , mundet që te dëgjuesi të lënë gjurmë në zemrën e tij, e si pasoj e saj të jetë pranimi i islamit (udhëzimi). Ndërsa, nëse bëhesh shkaktar që dikush të udhëzohet në islam, atëherë shpresohet në një shpërblim të madh nga Zoti i Madhëruar.

Transmetohet nga Sehl b. Sa'di r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë Aliut r.a.:

“Pasha All-llahun , që All-llahu nëpërmjet teje ta udhëzojë një njeri është më mirë për ty se sa të fitosh një kope të deveve më të mira”.⁷⁴

⁷³ “Kitabul Melahim”, vëll.IV. f.106, nr.4291.

⁷⁴ "Sahihul Buharij", vëll.III, fq.1077, nr.2783.

Këtë temë në vazhdim do ta shtjellojmë në disa nëntituj:

1. Vlera e atij, i cili i mëson të tjerët

Mësimi i të tjerëve bëhet përmes të folurit dhe veprave. Ai, i cili ia mëson të mirën tjetrit, ka vlerë të madhe dhe është i nderuar te Zoti i Madhëruar. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(

“Dhe kush mund të flasë më bukur se ai që thërret për në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë se unë jam prej muslimanëve”. (Fussilet ,33)

Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet hadithi:

*“Kur vdes njeriu, sevapet i pushojnë t'i arrijnë, përveç në tri raste: sadaqasë së përhershme, diturisë prej të cilës ka dobi njerëzia dhe fëmijës së mirë i cili lutet për të”.*⁷⁵

Nga hadithi nxjerrim se pronari i diturisë, i cili atë ua mëson, apo e shkruan në libër që të shërbehen të tjerët, ai për të do të ketë dobi edhe pas vdekjes.

Ajo që shkakton, që një popull të jetë më i dobishëm, pas besimit në All-llahun, është mësimi i të mirës të tjerëve. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(...

⁷⁵ "Sahihu Muslim", vëll.III, fq.1255, nr.1631.

“Ju jeni popull më i dobishëm , i ardhur për të mirën e njerëzve , të urdhëroni për të mirë , të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun”. (Ali Imran, 110)

Me dituri udhëzohen njerëzit , ndërsa udhëzimi i njerëzve ka shpërblim të madh. Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

...

*“Kush thërret në rrugë të drejtë , ka shpërblim për të, aq sa ka edhe ai që e ndjek, pa u zvogëluar aspak shpërblimi i atyre që e kryejnë ... ”.*⁷⁶

Po ashtu edhe hadithi:

“Më i miri nga ju është ai, i cili në rend të parë mëson Kur’anin, e pastaj ua mëson të tjerëve”.

2. Obligimet e dijetarëve për shpërndarjen e diturisë

Atëherë, kur dijetarët janë larguar nga obligimet e tyre, mund të shohim rënien e muslimanëve, në gjendjen në të cilën gjendemi. Dijetarët do të përgjigjen para All-llahut për ummetin e tyre. Ata kanë përgjegjësi për thirrjen në islam siç e cek ajeti:

.(...)

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillime të mira”. (Nahl, 125)

⁷⁶ "Sahihu Muslim", vëll.IV, fq.2060, nr.2674.

- Ibni Batali mendon se përpjekja për përhapjen e diturive islame është detyrë e dorës së parë për muslimanët (farzi kifaje) . Ai thotë se çdo musliman, i cili mëson ose dëgjon diç nga tjetri, është i detyruar t’ia përcjellë atë dije tjetrit.

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s., në fjalimin në të cilin e ka mbajtur pas çlirimit të Mekës, në fund ka shtuar:

...
“...Ata që janë të pranishëm , le t’ua transmetojnë këtë atyre, që nuk janë të pranishëm!”⁷⁷

Në këtë pjesë të hadithit theksohet nevoja që çdo fjalë e ligjëruesit t’u përcillet atyre që nuk janë të pranishëm në ligjëratë.

Pejgamberit s.a.v.s. i erdhën disa burra , delegacioni i fisit të Abdul Kajsit dhe pasi që i këshilloi dhe i mësoi në fund tha:

...
“...Mbajeni në mend këtë, ua transmetoni atyre pas jush”.⁷⁸

Pra, muslimani nuk duhet që të mbes injorant , duke u arsyetuar se nuk ka arsimim përkatës , përkundrazi ai duhet që t’ua mësojë të tjerëve atë që e di pa kurrfarë të mete! Fakihët⁷⁹ kanë thënë: “ *Kush e di një mes’ele (rregull), është bërë fakih në të , dhe borxh e ka t’ua mësojë të tjerëve*”. Gjë e mirë në përhapjen e diturisë është maksima: “*U Mësova të tjerëve atë që e di*”.

⁷⁷ "Fet’hul Bari", vëll.I, fq.267 nr.104.

⁷⁸ "Fet’hul Bari", vëll.I, fq.248 nr.87.

⁷⁹ Dijetari i cili është i specializuar në lëmin e sherijatit (ligjit islam).

- Transmetohet nga Abdull-llah b. Mes'udi r.a. se i dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë:

:

*“Mund të kesh zili në dy raste: ndaj njeriut të cilit All-llahu i ka dhënë pasuri dhe atë (pasuri) e shpenzon në rrugë të drejtë dhe ndaj njeriut , të cilit All-llahu i ka dhënë dituri, që gjykon sipas saj dhe i mëson edhe të tjerët”.*⁸⁰

Në këtë hadith përmenden dy gjëra: pasuria dhe dituria. Ashtu, sikurse pasurisë që është obligim t’i epet zekati e të shpenzohet në rrugën e All-llahut të Madhëruar, po ashtu edhe diturisë duhet që t’i epet zekati e t’ua tregosh atë të tjerëve. Prandaj, themi se zekati i diturisë është shpërndarja e saj”. Transmetohet nga Ebu Hurerje r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Shembulli i atij që mëson dituri e pastaj nuk e fletë, është sikur shembulli i atij që mbledh pasuri dhe nuk shpenzon prej sajë”.*⁸¹

Njëherit, mësimi i të tjerëve atë që e di, është sadakë, siç ka thënë Pejgamberit a.s.:

*“Sadakaja më e vlefshme është, kur njeriu ia mëson muslimanit një dituri, e ai pastaj ia mëson vëllait tjetër musliman”.*⁸²

⁸⁰ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.223 nr.73.

⁸¹ "Mexhmeuz - Zevaid", Alij bin Ebi Bekr El-Hejthemijju, vëll.I, fq.164.
Poashtu në "El Evset", nr. 693.

⁸² "Sunen Ibni Maxheh", vëll.I, fq.89, nr.243.

- Dijetarët kanë përgjegjësi për urdhërim në të mirë e pengimin nga të këqijat . Transmetohet nga Ibni Mes'udi:

...

"...Kujdes, pasha All-llahun ju me siguri , ose do të urdhëroni në vepra të mira dhe do të ndaloni nga të këqijat , ose do ta rrëmbeni dorën e zullumqarit dhe me forcë ta detyroni në të vërtetën , ose All-llahu do t'ju bie (rrah) me zemrat e njëri për tjetrin , e pastaj do t'ju mallkojë, siç i ka mallkuar ata... " ⁸³

Duke u nisur nga ajo, që cituam më lartë, dijetari obligohet që të predikojë thirrjen (da'ven) në rrethin e tij, mësuesi gjatë shpjegimit, nxënësi në shkollë, nëpunësi dhe punëtori në vendin e punës, tregtari në treg, prindi në familje, gruaja në shtëpi dhe në mesin e motrave të veta. Për këtë All-llahu i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(...

"Besimtarët dhe besimtare të dashamirë të njëri-tjetrit , urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja ..." .

(*Tevbe, 71*)

⁸³ "Sunen Ebu Davud", vëll.IV, fq.121, nr.4336. Tirmidhiu thotë se ky hadith është hasen .

3. Nxitja për përhapjen e diturisë dhe mosfshehja e saj

Kuptohet, që çdo besimtar është i obliguar që të predikojë këtë fe, për t'ua mundësuar edhe të tjerëve njohjen e kësaj feje.

Të diturve u tërhiqet vërejtja, që të angazhohen deri në fund, për t'i mësuar të tjerët, që njohuritë e tyre mos t'i fshehin, por t'ua transmetojnë të tjerëve.

Fshehja e diturisë dhe e realitetit është nga cilësitë e jahudive.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(

“Atyre që u kemi dhënë librin, ata e njohin atë (Muhammedin) siç i njohin bijtë e vet, e një grup prej tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke e fshehur të vërtetën”.

(El-Bekare, 146)

si dhe ajetin:

)

.(

“Dhe kur All-llahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t'ua publikoni atë njerëzve, e të mos e fshihni, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; Pra, bënë punë të keqe”. *(Ali Imran, 187)*

Ibn Haxher el Askalani në librën e tij Fet'hul Bari thotë se, kur halifja e muslimanëve Umer b. Abdul Azizi ka shkuar te dijetari i njohur i asaj kohe Ebu Bekr b. Hamzi dhe e ka urdhëruar për të filluar tubimin e haditheve të Pejgamberit s.a.v.s., duke thënë:

*“Prano vetëm hadithet e Pejgamberit s.a.v.s.! Le ta përhapin dijen dhe le ta ligjërojnë atë vazhdimisht , që të mësohet edhe ai që nuk di , sepse dijenia nuk do të shkatërrohet derisa ajo nuk do të jetë e fshehtë”.*⁸⁴

- Kërcënimi ndaj atyre, të cilët e fshehin diturinë

Asnjëherë nuk i lejohet dijetarit që ta fshehtë diturinë e vet për të kënaqur qeverinë tirane sepse në atë është vdekja e vërtetë dhe shkatërrimi. Të tillët kërcënohen me një dënim të madh. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(

“Ata që fshehin nga libri atë që e shpalli All-llahu dhe për të fitojnë shumë të paktë , ata në barqet e tyre fusin vetëm zjarr. Atyre All-llahu nuk do t’u flasë në Ditën e Gjykimit dhe as nuk i shfajëson ata, por për ta pason dënim i rëndë e i padurueshëm”.

(El-Bekare , 174)

Ndërsa në transmetimin e Abdull-llah Ibn Amrit thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë :

*“Kush e fsheh diturinë, All-llahu në Ditën e Kjjametit do ta frenon me frerë zjarri”.*⁸⁵

⁸⁴ “Fet’hul Bari”, vëll. I.fq. 234, boton Darul Fikri 1993, botimi i pare, Bejrut.

⁸⁵ "El Kebir", vëll.XI, fq.5, nr.10845.

Ibni Ethirit thotë: “Ai që përmbahet nga fjala i shëmbëllen atij, i cili ia vë vetes frerin”. Kjo do të thotë se ai ia ka vënë vetes frerin nga fjala e vërtetë dhe njoftimi i diturisë. Ky ndëshkohet në botën tjetër me një fre prej zjarri. Këtu bëhet fjalë për atë dituri, të cilën duhet mësuar dikujt, dituri e cila i është bërë obligim atij. Siç është rasti me atë që e sheh një jobesimtar, i cili dëshiron ta pranojë fenë islame dhe kërkon duke thënë: “Më mësoni ç’është Islami, ç’është feja?” Ai, i cili ka ardhur dhe parashtron pyetje për hallallin ose haramin, që kërkon fetva, kërkon udhëzim. Në këto raste është e domosdoshme që atij t’i jepet përgjigje. Ai që përmbahet në këto raste vërtet e meriton dënimin. Por, nuk është e njëjtë gjendja me dituritë “nafile” (njohuri të cilat nuk janë të domosdoshme të dihen).⁸⁶

Më të kujdesshëm në mos fshehjen e dijenisë i hasim se ishin sahabët e Pejgamberit s.a.v.s.. Ata kishin shumë frikë nga fshehja e diturisë. Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. , i cili tregon se populli thoshte:

. :
 ...{ } : - { } :

“Ebu Hurejre është më i frytshmi (në transmetimin) e haditheve : E unë nuk do të kisha thënë asnjë hadith, po të mos ishin këto dy ajete në librin e All-llahut (në Kur’an). Pastaj i citoi : “Ata të cilët fshehin argumentet dhe faktet që ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruam njerëzve në librin, të tillët i mallkon All-llahu , i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. Përveç atyre që pendohen, që përmirësohen dhe që u shpjegojnë njerëzve (të vërtetën), të tillëve ua pranoj pendimin, se Unë pranoj shumë pendimin, jam mëshirues”. (El-Bekare , 159-160)⁸⁷

⁸⁶ "Xhamiul Usul", vëll. VIII, fq. 12.

⁸⁷ "Fet’hul Bari", vëll.I, fq.289 nr.118.

Gjithashtu transmetohet nga Enes b. Maliku r.a., se Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë Muadh b. Xhebelit :

“Ai, i cili nga thellësia e shpirtit dëshmon se nuk ka Zot përveç një All-llahu dhe se Muhammedi është Pejgamberi i Tij, All-llahu do ta ruajë nga zjarri i Xhehenemit”. “O Resulull-llah, a ta lajmëroj popullin për këtë, që të gëzohet?”, pyeti Muadhi. Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Atëherë do të mbështetet vetëm në këtë”. Duke pasë frikë se do të bie në gabim për shkak të fshehjes së dijenisë, këtë hadith Muadhi e paraqiti mu para vdekjes së tij.”⁸⁸

Nga ky hadith shohim se ajo që e shtyri sahabiun e ndershëm Muadh b. Xhebelin r.a. që këtë hadith t’ua paraqes të tjerëve, mu para vdekjes së tij, ishte frika që të mos bie në gabim me fshehjen e diturisë.

Disa dijetarë kanë thënë: "Kërcënimi për fshehjen e diturisë, e përfshinë edhe mosdhënien e librave atij që i kërkon (studenti), sidomos kur (një libër) nuk është i shumtë në numër. Kanë thënë se me këtë mjerisht janë sprovuar shumë".⁸⁹

⁸⁸ "Fet’hul Bari", vëll.I, fq.304 nr.128.

⁸⁹ Transmeton nga Sahaviu dijetari i afirmuar El-Kari në komentën “El-Mushkatë” nga vepra “El-Mekasid El-Hasene”. Shiko “El-Mirkatë”, vëll.I, fq.235.

KAPITULLI I KATËRT

IV

KËRKIMI I DITURISË DETYRË EDHE E FEMRAVE MUSLIMANE

- CAKTIMI I LIGJËRATAVE VETËM PËR GRA
- GRATË E GJENERATËS SË PARË TË
MUSLIMANËVE- GRATË E PEJGAMBERIT
s.a.v.s. dhe GRATË E SAHABËBE

KËRKIMI I DITURISË DETYRË EDHE E FEMRAVE MUSLIMANE

Mashkulli dhe femra tek All-llahu janë të njëjtë; Ai është Zot i të gjithëve, Krijues i të gjithëve. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

_____)
.(

“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre”. (Nahl, 97)

Nga ajeti i lartpërmendur thënia “qoftë mashkull ose femër”, kuptojmë se vepra e mirë pranohet edhe nga mashkulli edhe nga femra, ndërkaq për veprën e keqe ndëshkohet edhe mashkulli edhe femra. Pra, drejtësia e Allahut të Madhëruar është e njëjtë për të dy gjinitë.

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

طلب العلم فريضة على كل مسلم .

*“Kërkimi i diturisë është obligim i shenjtë i çdo muslimani”.*⁹⁰

Hadithi nuk e ka përcaktuar kërkimin e diturisë vetëm për meshkuj, por për çdo pjesëtar të fesë islame, qoftë mashkull, qoftë femër. Nga këtu mundë themi se, për gratë është obligim të marrin mësim nga feja, njësoj siç është obligim për meshkujt e

⁹⁰ Transmeton Ibni Maxhe Transmeton Abdurr-Rrezaku në Musennefin e tij Sahih).nga libri “Sahihut –Tergibi vet-Terhibi” nga Muhammed Nasirudin Albani vëll. I. f.106 nr. 69.

këtij ummeti. Ato duhet t'i njohin dispozitat islame dhe nuk ka kurrfarë dallimi në këtë çështje, në mes tyre dhe meshkujve. Ato janë të obliguara të marrin dituri, qoftë vetëm ose me leje paraprake që dikush t'i mësojë. Është obligim i sundimtarit islamik që tu ndihmojë në këtë!

Me një fjalë, Islami na mëson se gruaja është shtyllë dhe themel i shoqërisë. Si shtyllë e shoqërisë islame, gruaja duhet të ketë njohuri për të qenë në gjendje t'i edukojë gjeneratat e ardhshme, të cilat do ta bartin flamurin e kësaj feje të përsosur.

a) Caktimi i ligjëratave vetëm për gra

Rëndësinë e diturisë e kishin kuptuar gratë e para muslimane, kur kishin ardhur te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i kishin thënë;

غَلَبْنَا عَلَيْكَ الرَّجَالُ ، فَاجْعَلْ لَنَا يَوْمًا مِنْ نَفْسِكَ . فَوَعَدَهُنَّ يَوْمًا لَقِيَهُنَّ فِيهِ فَوَعظَهُنَّ
وَأَمَرَهُنَّ ، ...

"Meshkujt na e kanë bërë të pa mundur pjesmarrjen (për shkak të kallballëkut) në ligjëratat tuaja, prandaj caktoje një ditë vetëm për ne". Ai, pastaj, caktoi një ditë vetëm për ato. Ua mësoi dhe ua caktoi urdhrat.⁹¹ Gjithashtu Pejgamberi s.a.v.s. i nxiste gratë të prezantonin në namazet e Bajrameve, madje edhe nëse ishin me hajz (memonstruacine). Krejt kjo, për shkak të dëgjimit të hytbes së bajramit.

Nga hadithi i lartë përmendur kuptojmë se ligjëratat duhet t'u organizohen edhe grave. Atyre t'u mësohen rregullat islame, detyrat e amvisërisë së mirë dhe nënave shembullore.

Një fjalë popullore thotë:

"Një nënë e shkolluar-arsimuar zëvendëson ca profesorë".

⁹¹ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.264 h.101.

a) Gratë e gjeneratës së parë të muslimanëve – grate e Pejgamberit s.a.v.s. dhe gratë e sahabëve

Prej momentit kur All – llahu i Madhëruar e nderoi gruan me islam, ajo me zell iu qas kërkimit të diturisë. Gratë e Pejgamberit s.a.v.s. dhe gratë e Sahabëve (shokëve) të tij i kushtonin shumë rëndësi kërkimit të diturisë.

Aishja r.a. ka thënë:

نِعْمَ النِّسَاءُ نِسَاءُ الْأَنْصَارِ ، لَمْ يَمْنَعُنَّ الْحَيَاءُ أَنْ يَتَفَقَّهْنَ فِي الدِّينِ .

“Gra të shkëlqyeshme janë gratë Ensare, ato nuk i pengon turpi që të mësojnë fenë”.⁹²

Pra, Aishja gruaja e Pejgamberit s.a.v.s. ka lavdëruar gratë medinase për vullnetin e tyre në kërkimin e diturisë.

Historia islame dëshmon se Muhadithinët (njohësit e hadithit) e mëdhenj, një pjesë të madhe të haditheve e transmetuan pikërisht nga gratë, të cilat jetuan në kohën tyre.

Shpesh hasim ata duke thënë:

“Më ka treguar një muslimane emirë, filanja e bija e filanit” etj.

Dijetari i njohur Samerkandi, kur ndodhte që të nxirrte fetva për ndonjë çështje, ai e linte që edhe bija e tij Zejnebja (e cila ishte e ditur) të jepte mendimin e vet. Ai bashkëpunimin më të madh e hasi te bija e tij, e cila ishte e njohur me dhënien e fetfave.

Kështu ishte çështja e muslimaneve në atë kohë kur kuptuan rëndësinë e kërkimit të diturisë, kohë kjo që civilizimi islam kishte arritur kulminacionin e tij.

⁹² "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.308.

- Shembull në dëshirën për kërkimin e diturisë për motrat tona muslimane kemi gratë e Pejgamberit s.a.v.s..

Gruaja e Pejgamberit s.a.v.s., Hafsa bint Omer ibni Hattab r.a. në Kohën e Xhahilijetit kishte mësuar shkrim leximin nga një grua e arsimuar me emrin Shifaul Adevijje. Kur Pejgamberi s.a.v.s. e martoi Hafsën, kërkoi nga Shifaul Adevijje t'ia mësojë Hafsës Kaligrafinë (bukur shkrimin) arabe.

Urva ibn el-Zubair për gruan e Pejgamberit s.a.v.s. ka thënë: “Nuk kam parë ndonjë njeri më të ditur se Aishen, si në medicinë, poezi ashtu edhe në jurisprudencë”.

Hakim Ebu Abdull-llahu thotë: “Aisha e ka transmetuar çerekun e Sheriatit (jurisprudencës islame)”.

Aisha r.a. (gruaja e Pejgamberit s.a.v.s.) ka transmetuar mijëra hadithe nga Pejgamberi s.a.v.s. dhe ia tejkalonte shumë transmetuesve nga Sahabët.

Hafiz Abdul-Mexhid el-Kureshi thotë:

*“Buhariu dhe Muslimi i transmetojnë një mijë e dyqind hadithe në lidhje me dispozitat islame. Prej atyre haditheve Aisha (gruaja e Pejgamberit s.a.v.s.), dyqind e nëntëdhjetë hadithe. Të gjitha këto hadithe janë të lidhura me dispozitat islame”.*⁹³

⁹³ (Hafiz Abdul-Mexhid el-Kureshi, libri “idah ma la jeseu elmuhadisu xehle”.

KAPITULLI I PESTË

V

NGA METODOLOGJIA E LIGJËRIMIT TË MUHAMMEDIT s.a.v.s.

- TË PARASHTRUARIT E PYETJEVE PARA DËGJUESËVE
- PËRSËRITJA E FJALËVE NGA TRI HERË, ME QËLLIM QË TË KUPTOHET MË MIRË
- PËRDORIMI I DUARVE PËR KONKRETIMIN E QËSHTJEVE GJATË LIGJËRIMIT
- TË FOLURIT E QARTË

NGA METODOLOGJIA E LIGJËRIMIT TË MUHAMMEDIT s.a.v.s.

Me oratori nënkuptojmë aftësinë e ligjëruesit në të shprehurit me fjalë dhe lëvizje gjatë ligjërimit, me qëllim që t'ua bëjë më të kuptueshëm ligjërimit. Me një fjalë oratoria ka të bëjë me mjeshtërinë e përdorimit të fjalëve dhe gjesteve në ligjërata, shtjellimin e çështjeve në atë mënyrë që të mbahen në mend dhe njëherit tek dëgjuesi të len gjurmë.

Për metodologjinë e ligjërimit të Muhammedit s.a.v.s. nevojitet të flitet gjerë e gjatë, njëherit nevojitet më shumë studim me qëllim që t'ia japim hakun (të drejtën) kësaj teme.

Në vazhdim kam cekur vetëm disa pika të cilat kanë të bëjnë me oratorinë e Pejgamberit s.a.v.s.

a) Të parashtruarit e pyetjes para dëgjuesve

Kjo është një metodë efikase me qëllim që të provohet dijenia dhe njëkohësisht të jetë nxitje për angazhimin e të menduarit.

Transmetohet nga Ibni Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

{ إِنَّ مِنَ الشَّجَرِ شَجْرَةً لَا يَسْقُطُ وَرَقُهَا وَإِنَّهَا مَثَلُ الْمُسْلِمِ ، حَدَّثُونِي مَا هِيَ ؟ }
قال : فَوَقَعَ النَّاسُ فِي شَجَرِ الْبَوَادِي . قال عبدُ الله : فَوَقَعَ فِي نَفْسِي أَنَّهَا النَّخْلَةُ . ثُمَّ
قالوا : حَدَّثْنَا مَا هِيَ يَا رَسُولَ اللَّهِ ؟ قال : { هِيَ النَّخْلَةُ } .

“Është një pemë, gjethet e së cilës nuk bien; ajo i ngjanë muslimanit.

Më tregoni cila është ajo?” Abdull-llahu ka thënë: “Njerëzit menduan për ndonjë pemë të shkretëtirës, kurse mua më shkoi mendja se ajo (pemë) është hurma”. Pastaj të pranishmit pyetën: “O i Dërguar i All – llahut, na thuaj cila është ajo?” Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj: “Ajo pemë është hurma”.⁹⁴

⁹⁴ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.200 nr. 62

Pyetja e Pejgamberit s.a.v.s., ishte ajo që i shtyri të thellohen në atë se, cilat ishin gjërat që hurma t'i ngjasojë besimtarit. Përfundimi ishte se hurma e tëra është e dobishme, kështu që ajo shfrytëzohet e tëra; trangu i sajë, gjethet po ashtu edhe frytet; sikurse besimtari që është i dobishëm për shoqërinë.

b) Përsëritja e fjalëve nga tri here, me qëllim që të kuptohen më mirë

Ndër metodat e oratorisë që duhet t'i përdorë dijetari gjatë ligjërimit është edhe përsëritja e deklaratave, me qëllim që ligjërimi t'i bëhet dëgjuesit më i kuptueshëm, dhe njëherit ta mban mend më mirë.

عن أنس عن النبي صلى الله عليه وسلم أنه كان إذا تكلم بكلمة أعادها ثلاثاً حتى تفهم عنه ، و إذا أتى على قوم فسلم عليهم سلم عليهم ثلاثاً .

Transmetohet nga Enesi r.a., e ky nga Pejgamberi s.a.v.s. se ai (Pejgamberi), kur diçka fliste , e përsëriste tri herë, që të kuptohej më mirë, e kur dilte para masës, përshëndeste tri herë”.⁹⁵

Ibni Umeri ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. (kur ka dashur të theksojë diçka) tri herë ka përsëritur:

{ هَلْ بَأَعْتُ ؟ ثَلَاثًا }

“A ju kam njoftuar mirë?”⁹⁶

⁹⁵ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.254 nr.95

⁹⁶ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.254

c) Përdorimi i duarve gjatë ligjërimit për konkretimin e çështjeve

Ligjëruesi gjatë ligjërimit mund që t'i përdorë duart për konkretimin e asaj që e shpjegon, kjo ua bën dëgjuesve më të kuptueshëm çështjen.

عن ابن عباس أن النبي (صلى الله عليه وسلم) سُئِلَ فِي حَجَّتِهِ فَقَالَ : دَبَحْتُ قَبْلَ أَنْ أُرْمِيَ ، فَأَوْمَأُ بِيَدِهِ قَالَ : { لَا حَرَجَ } قَالَ : وَحَلَقْتُ قَبْلَ أَنْ أَدْبَحَ ، فَأَوْمَأُ بِيَدِهِ : { وَلَا حَرَجَ } .

Transmetohet nga Ibni Abbasi r.a. se në Haxhin Lamtumirës është pyetur Muhammedi s.a.v.s. nga dikush: “Kam prerë kurban para se të hedh guralecët?”

Ai pastaj sinjalizoi me dorë dhe tha : “Nuk ka dëm (gabim)”.

Një tjetër pyeti : “Kam rruar qokën para se të pres kurban?”

*Pejgamberi s.a.v.s., përsëri sinjalizoi me dorë dhe tha: “Nuk ka gabim (gjynah)”.*⁹⁷

Pra, nga metodologjia e ligjërimit të Pejgamberit s.a.v.s. bën pjesë edhe përdorimi i duarve në sqarimin e çështjeve. Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

{ يُقْبَضُ الْعِلْمُ ، وَيَظْهَرُ الْجَهْلُ وَالْفِتْنُ ، وَ يَكْتُرُ الْهَرْجُ } . قِيلَ : يَا رَسُولَ اللَّهِ وَ مَا الْهَرْجُ ؟ فَقَالَ : { هَكَذَا بِيَدِهِ فَحَرَّقَهَا } كَأَنَّهُ يُرِيدُ الْقَتْلَ .

“Do të bie interesimi për dituri, do të paraqitet mosdija dhe ngatërresat. Edhe çrregullimi (herxhi) do të shumëfishohet”.

“O i Dërguar i All-llahut, çka është herxhi?” pyeti dikush.

*“Kështu” e lëvizi dorën, bile e përmbysi, sikur kishte për qëllim therje (prerje).*⁹⁸

⁹⁷ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.244 nr. 84

d) Të folurit e qartë

Dijetari përgjigjet shkurt, e sipas nevojës edhe më gjatë dhe duhet të jetë sa më i qartë.

Transmehyhet se Aishja r.a. ka thënë:

كَانَ كَلَامُ رَسُولِ اللَّهِ (صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ) كَلَامًا فَصْلًا يَفْهَمُهُ كُلُّ مَنْ يَسْمَعُهُ .

*“Pejgamberi s.a.v.s. në fjalimin e vet ishte i qartë dhe çdo kush që e dëgjonte e kuptonte”.*⁹⁹ Për oratorin e Muhammedit s.a.v.s. nevojitet të flitet më gjerë dhe gjatë.

Enesi r.a. kur flet për oratorinë e Muhammedit s.a.v.s. thotë:

*“Kur ka folur, fjalën e ka përsëritur tri herë”.*¹⁰⁰

Pejgamberi a.s. këtë e ka bërë derisa çështja është kuptuar. Të shpejtuarit në të folur nuk është e mirë, është e urryer të folurit e pandërprerë, të folurit e pa nevojë, të ngarkuarit e vetes në të folurit për të zgjedhur fjalë të mëdha p.sh.: mendjemadhësinë, të folurit e fjalëve të pakuptueshme etj”.

⁹⁸ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll.I, fq.245 nr. 85

⁹⁹ Transmeton Ebu Davudi, "Rijadus Salihin", Imam En Nevevij, boton Darus Selam, Kajro, botimi i parë 1993 fq.144 h.697

¹⁰⁰ Muttefekun alejhi dhe Ebu Davudi Ebu Davudi vëll. III, f. 319, h. 3653

KAPITULLI I GJASHTË

VI

ÇKA DUHET PASUR KUJDES KËRKUESI I DITURISË (DIJETARI)

- FRIKA NDAJ ALL-LLAHUT TË
MADHËRUAR
- NIJETI I SINQERT
- TURPI GJATË KËRKIMIT TË DITURISË
- TË VEPRUARIT ME ATË QË E DIN
- MOSTREGIMI I NDONJË LLOJI TË
DITURISË PËR SHKAK SITUATËS DHE
SIGURISË
- KUJDESI QË TË NJOFTOHEN VETËM DISA
NGA FRIKA E KEQKUPTIMIT NGA TË
TJERËT
- KUJDESI NGA DHËNIA FETVA PA DIJENI
- KUJDESI GJATË TRANSMETIMIT TË
HADITHEVE DHE NDALIMI I SHPIFJES
NDAJ PEJGAMBERIT s.a.v.s.
- KUJDESI QË MËSIMI TË MOS KALOJË NË
MONOTONI

CKA DUHET PASUR KUJDES DIJETARI

1. Frika ndaj All-llahut të Madhëruar

Gjëja e parë që dijetari duhet të ketë kujdes është frika ndaj All-llahut. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“Keni frikë All-llahun se All-llahu ju dhuron dituri, ...”.

(El-Bekare, 282)

Dijetarë të mirëfilltë janë ata, të cilët besojnë All-llahun e Madhëruar, që e njohin fuqinë e Tij, dijeninë e pa fund të Tij, drejtësinë e Tij dhe i kryejnë urdhrat e Tij me përkushtim të plotë.

Gjithashtu, kur është në pyetje thënia e të vërtetës, dijetari duhet të mos ketë frikë nga askush, përpos nga All-llahu. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

)

.(

“(Ligj i All-llahut ndër) Ata, të cilët i kumtojnë shpalljet e All-llahut, i frikësohen vetëm All-llahut e askujt tjetër pos Tij, e All-llahu është i mjaftë të jetë llogaritës”. *(El-Ahzabë, 39)*

Dijetari, i cili vepron me diturinë e tij, të tjerët i mëson dhe në të thërret, me këtë vepër, ai nuk i frikësohet askujt, as masës as kryetarit. Ai nuk frikësohet as për autoritetin e as për komoditetin e tij. Nuk e frikësojnë as kërcënimet e ndokujt dhe as nuk lakmon për premtimet e majme të tjetrit, por ai i frikësohet vetëm All-llahut, dënimit të Tij. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“... E kush iu përmbahet dispozitave të All-llahut (kush iu frikësohet All-llahut), atij Ai i hapë rrugë”. (Et Talakë, 2)

Ai që në mesin e njerëzve e njeh All-llahun e Madhëruar më shumë, ai i frikohet Atij më shumë:

()

“All-llahut i frikohen nga robërit e Tij vetëm dijetarët”.

(Fatir,2)

Kërkuesi i diturisë e ka për obligim frikën ndaj All-llahut të Madhëruar, ta punon atë të cilën All-llahu e ka urdhëruar dhe të largohet nga ajo të cilën All-llahu e ka ndaluar.

2. Nijeti i singertë

Dijetari apo kërkuesi i diturisë duhet pasur kujdes që të kërkojë diturinë me sinqeritet, për të fituar kënaqësinë e Zotit të Madhëruar dhe shpërblimin e Tij në botën tjetër. Një fjalë e urtë thotë:

”Fillimi i mësimit, është qëllimi e pastaj dëgjimi, pastaj kuptimi, pastaj memorizimi, pastaj praktika, pastaj përhapja (shpërndarja)”.

Vlera dhe rëndësia e kërkimit të diturisë në këndvështrimin e islamit, shihet qartë në faktin se ajeti dhe urdhri i parë në islam është: **”Lexo”**, mirëpo në vazhdim të këtij ajeti ceket një çështje shumë me rëndësi, se fjala **“Ikre”** **“Lexo”** është dhënë bashkë me emrin e All-llahut në formën:

.()

që do të thotë: **”Lexo me emrin e Zotit tënd ...”** (Sureja Alak,1) , sepse të lexuarit, jo në emrin e All – llahut (jo me sinqeritet) në vend të begatisë dhe lumturisë, sjellë njerëzimit fatkeqësi! Transmetohet nga Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

...

*“Me të vërtetë veprat janë vetëm sipas qëllimeve, për çdo njerin i takon ajo që ka për qëllim...”*¹⁰¹

Ky hadith është një prej haditheve më të rëndësishëm. Vë në pah sinqeritetin, që është bazë e veprave. Nëse qëllimi është i sinqertë, edhe vepra e bërë nga besimtari, është e pranuar te All-llahu dhe do të shpërblehet.¹⁰² Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Nijeti i besimtarit është më i mirë se vepra e tij”*¹⁰³

Et-Tejmiu thotë: Nijeti është më i madh se vepra. Nijeti pranohet edhe pa vepër. Nëse ndokush ka për qëllim ta bëjë një të mirë, por nuk mund ta bëjë, do të shpërblehet për qëllimin e tij. Por nëse do ta bënte një të mirë pa nijet, nuk do të kishte shpërblim për atë vepër.¹⁰⁴

¹⁰¹ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.15 nr.1.

¹⁰² "Komentimi i Haditheve sipas metodologjisë shkencore", Mr. Musa Vila, fq.13, 2002 Prishtinë.

¹⁰³ "Musnedurr Rrabi'a", vëll.I, fq.23, nr.1.

¹⁰⁴ "Komentimi i Haditheve sipas metodologjisë shkencore", Mr. Musa Vila, fq.18, 2002 Prishtinë.

- **Kërcënimi ndaj atij, i cili mëson për tu lavdëruar**

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*"Kush e mëson një dituri, e cila duhet të mësohet për hirë të fytyrës së All-llahut, por e mëson për të fituar diç nga të mirat e kësaj bote, nuk do të shijojë erën e xhennetit në Ditën e Gjyqimit".*¹⁰⁵

Në këtë hadith i hasim dy lloje nijetesh:

1. Nijeti për ta fituar kënaqësinë e All-llahut, shpërblimi i të cilit është xhenneti,
2. Nijeti për të fituar diç nga të mirat e kësaj bote.

Sa i përket llojit të parë të nijetit, kuptohet se kush e bën një vepër të mirë për ta fituar kënaqësinë e Zotit, vepra e tillë është e pranuar dhe për te besimtari do të shpërblehet.

Ndërsa sa i përket llojit të dytë të nijetit, kuptohet se kush bën një vepër jo për hir të All-llahut, atëherë vepra e tillë është e papranuar tek All-llahu i Madhëruar.

Hasani (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

*"Ndëshkimi i dijetarit është vdekja e zemrës së tij, ndërsa vdekja e zemrës bëhet duke e kërkuar këtë botë me vepra të ahiretit (botës tjetër)".*¹⁰⁶

- Prandaj, kërkimi i diturisë për të fituar diç nga kjo botë, është edhe kërkimi i diturisë për mendjemadhësi dhe për nënçmimin e të tjerëve e që kjo është dështim i qartë, siç shihet në transmetimin e Ka'b ibn Malikut r.a., se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

¹⁰⁵ "Musned Ahmed", vëll.II, fq.338, nr.8438.

¹⁰⁶ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.53.

3. Turpi gjatë kërkimit të diturisë

Turpi është karakteristikë pozitive e njeriut dhe se turpi është pjesë e imanit.

Turpi është dy llojesh: Turpi i dobishëm dhe ai i urryer.

a). Sa i përket **turpit të dobishëm** transmetohet nga Umran ibni Hasini se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*"Turpi nuk sjell tjetër përveç të mira".*¹⁰⁹

Thënia në hadith **"... nuk sjell tjetër përveç të mira"** kuptojmë se besimtari gjatë jetës së tij përballet me momente dhe sprova të ndryshme, prandaj atij, të cilit në kokë i sillet vërdallë, si të bëjë një vepër amorale, turpi e pengon që ta bëjë, ose të ofendojë ndonjë njeri, apo ta bëjë ndonjë të keqe tjetër. Pra, turpi ndërhyt ndërmjet njeriut dhe të shëmtuarës dhe e pengon nga vepra që e turpëron. Kështu morali i personit të tillë është i lavdëruar dhe nuk prodhon tjetër veçse të mira.

b). Mirëpo kërkuesi i diturisë duhet të ketë kujdes nga **turpi i urrejtur**.

*Aishja r.a. ka thënë: "Gra të shkëlqyeshme janë gratë ensare, ato nuk i pengon turpi që ta mësojnë fenë."*¹¹⁰

Kështu që, nuk duhet të mos e pyesësh profesorin tënd për një çështje, që nuk e ke kuptuar, ose ta shikosh duke u frikësuar se do të jesh gabim, apo nga turpi të mos pyesësh për çështje intime bashkëshortore, ose të qëndrosh duarkryq nga turpi e të mos i kundërvihesh atij që bënë mëkate, apo të mos e kërkosh atë që të takon dhe për të cilën ke nevojë - që të gjitha këto dhe veprime

¹⁰⁹ "Sahihul Muslim", vëll.I, fq.64, nr.37.

¹¹⁰ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.308.

të tjera të ngjashme nuk janë nga shenjat e turpit të lavdëruar, por të urryer.

Nexhadiu ka thënë: *”Dijeninë nuk e fiton ai që ka turp dhe ai që është kryelartë”*.¹¹¹

Ai, i cili ka turp nuk pyet, sepse ka turp, ndërsa ai i cili është mendjemadh nuk pyet, sepse e sheh veten më lartë, andaj mbeten të paditur. Mburrja është njëra nga perdet më të trasha para të vërtetës.

Aliu r.a ka thënë:

“Të mos turpërohet ndonjëri prej jush, nëse nuk di të mësohet. Por, nëse pyetet për diç që nuk e di, të thotë nuk e di”. Një ditë ai ishte pyetur për një çështje dhe ishte përgjigjur: “Unë nuk kam njohuri për këtë”. Pastaj ka thënë: “Kjo është freski për gjoksin, jam pyetur për atë që nuk e di, jam përgjigjur se nuk e di”.¹¹²

4. Të vepruarit me atë që e di

a). Të vepruarit me atë dituri që e ke mësuar

Dituria pa punë është si pema pa fryte, njëherit bari-ilaçi nuk mund t’i ndihmojë të sëmurit, përderisa nuk e përdorë atë.

Prandaj, që dijetari të ketë dobi në kërkimin e diturisë, duhet që diturinë ta kërkojë me qëllim që ta praktikojë. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“Dhe thuaj:”Veproni”, All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët”. (Tevbe, 105)

¹¹¹ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.308.

¹¹² "Kenzul Ummal", vëll.I, nr.1437.

Madje kur flet Kur'ani për besim, në dhjetëra ajete shohim se kërkon shoqërimin e tij me punë:

.(...)

“Ata, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira...”.

(*El – Bejjine, 7*)

Në rastin e Musait a.s. me Hidrin, pasi që Musai a.s. nuk bëri durim gjatë veprimeve të Hidrit e që nuk e dinte fshehtësinë e veprimit të tyre, Hidri hoqi dorë nga shoqërimi me Musain a.s.. Mirëpo, para se të ndahen, Musai a.s. e luti Hidrin që ta mësojë çka do qoftë, e Hidri i tha: *”Mos kërko dituri vetëm për ta përsëritur atë, por kërko dituri për ta zbatuar në jetën e përditshme”*.¹¹³

Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a., se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Dënimin më të madh në botën tjetër do ta provojë i dituri, i cili nuk ka sjellë dobi me diturinë e tij”.¹¹⁴ d.m.th. i cili nuk ka vepruar në frymën e diturisë.

Kështu që moskërkimi i diturisë shkakton humbje dhe dështim, gjithashtu mosveprimi me atë që e di shkakton ngecje dhe shkatërrim. Një fjalë e urtë thotë:

“Mjerë për atë që nuk mëson dhe mjerë shtatë herë për atë që mëson e nuk e përdorë atë”.

¹¹³ "Sahihul Buhari" në gjuhën shqipe, vëll.I, fq.138, botimi i parë, 1994, Prishtinë.

¹¹⁴ "Mexhmeus-Sagir", Taberani vëll. I, fq.305, nr. 182-183, Bejrut viti 1985.

b) Qortimi ndaj atyre, të cilët vet nuk punojnë punë të mira, ndërsa të tjerët i urdhërojnë për vepra të mira

Dijetari duhet së pari të veprojë mirë dhe njëherit të jetë i frenuar nga të këqijat, e tek pas kësaj t'i urdhëron të tjerët për punë të mira dhe t'i ndalon nga të këqijat, sepse në të kundërtën bëhet shembull i së keqes. Dituria e tillë është e ndarë nga morali. Kështu që njerëzit më tepër ndikohen me gjendjen (e dijetarit) se sa me fjalët.

Prandaj, mësuesi dhe nxënësi janë sikur shkopi dhe hija e tij; A mund të bëhet hija e drejtë përderisa shkopi është i shtrembër?!

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.()

“A ju po urdhëroni të tjerët të bëjnë vepra të mira e veten e harroni? Ju edhe Librin e lexoni. A s’po mendoni pak?” (Bekare,44)

Imam El Gazali ka thënë:

*”Ai, i cili i mëson të tjerët, ndërsa vetë nuk e praktikon atë, është sikur gjilpëra që i mbathë të tjerët, ndërsa vetë është lakuriqe, ose sikur fitili ndriçon të tjerët përderisa vetë shpenzohet”.*¹¹⁵

Ai, i cili urdhëron për punë të mira dhe ndalon nga punët e këqija, ndërsa vetë nuk vepron me diturinë e tij, kërcënohet me një dënim të madh.

Transmetohet nga Ebu Zejd Usame ibn Zejd r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

¹¹⁵ "Ihja Ulumud din", vëll.I, fq.48.

:
:
.
“Në Ditën e Gjyqimit do të sillet një njeri dhe do të hidhet në zjarr (Xhehennem), e organet e barkut do t’i dalin jashtë dhe do të sillet rreth tyre sikur që sillet gomari në rrotulluesen e mullirit. Banorët e Xhehennemit do të mbledhen rreth tij e do t’i thonë:

“O ti filan, çfarë të ka ndodhur? A nuk ke urdhëruar për vepra të mira dhe ke ndaluar nga të këqijat?” Ai do t’u thotë:

“Po, gjithsesi, kam urdhëruar për vepra të mira, por vetë nuk i kam kryer, dhe kam ndaluar nga të këqijat, por vetë i kam punuar”.¹¹⁶

Prandaj Zoti i Madhëruar në Kur'an na këshillon duke thënë:

) ()
(

“O besimtarë, përse flisni atë që nuk e punoni? Sa e urrejtur është tek All-llahu të flisni atë që s’e bëni! (Es-Saff, 2-3)

¹¹⁶ "Sahihu Muslim", vëll.IV, fq.2290, nr.2989.

5. Mostregimi i ndonjë lloji të diturisë për shkak të situatës dhe sigurisë-fitnes

Dijetari islam duhet pasur kujdes që në disa situata të posaçme t'i lërë anash disa mendime për shkaqe sigurie dhe njëherit të mos shkaktohet përçarje dhe fitne.

Transmetohet nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë:

:

*“Kam mbajtur nga Pejgamberi s.a.v.s. dy lloj dijenish: Njëren prej tyre ua kam treguar. Sa i përket tjetrës. po t'ua kisha treguar atë, do të më pritej ky laring (fyt)”.*¹¹⁷

Ebu Hurejre ka shprehur haptazi hadithet që kanë të bëjnë me detyrimet fetare (namaz, haxh, zekat, etj.) dhe që kanë të bëjnë me të drejtën e sheriatit (legjislaturës), ndërsa hadithet që flasin për situatën shoqërore-politike dhe për pandërgjegjshmërinë e udhëheqësve nuk i ka treguar haptazi, për shkak të sigurisë së vet personale. Shqetësimet dhe sprovat e ardhshme të botës islame Ebu Hurejre i ka thënë në mënyrë alegorike.

Përkundër kërcënimit me dënim ndaj atij që e fsheh diturinë, në disa raste lejohet që disa njohuri të mos publikohen. Në lidhje me këtë Dr. Jusuf Kardavi thotë: *“E drejtë e dijetarit është që disa njohuri të mos i publikojë, t'i fshehë nga disa njerëz, pasi të ketë konstatuar se ajo është e dobishme, qoftë edhe nëse ai pyetet, ngase po të përhapej ajo, do të mund të shkaktonte më shumë dëm se sa dobi.*

¹¹⁷ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.292 nr.120.

Ka raste kur nuk duhet përgjigjur në pyetje dhe atë për shkak të edukimit të pyetësit të inatosur, ose duhet udhëzuar në atë që është më e vlefshme dhe më e dobishme për të që ai të merret me të, ose të shfrytëzojë ndonjë parametër tjetër".¹¹⁸

Nganjëherë idetë e mira dhe të dobishme nuk zbatohen, sepse mund të shkaktojnë pasoja të padëshirueshme.

Transmetohet nga Esvedi i cili ka thënë: Ibni Zubejri më ka thënë:

:
)-] :
: - : (
. [

"Aisha të ka treguar ty shumë fshehtësi, e çka të ka treguar ty për Qaben?" "Më ka thënë", u përgjigja:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Aishe, ky populli yt, të mos ishte ende në kujtesë të ideve paraislame, e Ibni Zubejri ka thënë, në mosbesim, unë Qaben do ta zgjeroja dhe do t'i kisha vënë dy dyer; njëra nëpër të cilin do të hynin njerëzit dhe tjetra nëpër të cilin do të dilnin." Atë më vonë e bëri Ibni Zubejri.¹¹⁹

Pejgamberi s.a.v.s. në rastin konkret ka theksuar nevojën e zgjerimit të Qabes në themelet e ndërtesës së Ibrahimit a.s., por megjithatë, këtë nuk e bëri, duke u frikësuar nga keqkuptimi, ngatërresat dhe çrregullimet e atyre që posa e kishin pranuar islamin.

¹¹⁸ "Err-rresul vel Ilm"- "Pejgamberi a.s. dhe Dituria", të Dr. Jusuf Kardavit fq. 127 (në gjuhën shqipe).

¹¹⁹ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.302 nr.126 .

6. Kujdesi që të njoftohen vetëm disa nga frika e keqkuptimit nga të tjerët

Së pari është e nevojshme të dihet shkalla e përgatitjes arsimore e dëgjuesve, dëshirat dhe rrethanat e tyre, e pas këtyre njoftimeve t'u tregohet vetëm ajo për të cilën kanë nevojë dhe mundësi për ta kuptuar. Të diturit në mesin e të paditurve janë si mjekët në mesin e të sëmurëve, prandaj mjeku nuk e përdor barin pa ia gjetur sëmundjen.

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë Muadhrit r.a.:

“Çdo njeri i cili dëshmon me sinqeritet të plotë dhe me zemër të pastër, do të hyjë në xhenete dhe zjarri e ka të ndaluar të djegë trupin e tij”. Muadhri tha: O i Dërguar i Allahut, po, a t'i përgëzohet njerëzit për këtë që thua? Muhamedi s.a.v.s. tha: Jo, se frikësohem se ata do të mbështeten vetëm në këtë (e nuk do të angazhohen në ibadetet tjera)”.¹²⁰

Në këtë hadith vërejmë frikën e Pejgamberit s.a.v.s. në informimin e të tjerëve për shkak të keqkuptimit dhe pasojave që do të rridhnin më pas.

Aliu r.a. ka thënë: “Tregoni popullit atë që e kupton! A dëshironi të përgënjeshtrohet All-llahu dhe i Dërguari i Tij?”¹²¹

Aliu r.a. tërheq vërejtjen se duhet t'u përcillet njerëzve të tjerë, sipas mundësisë së të kuptuarit të tyre dhe me metoda të lehta. Atë që njerëzit nuk mundë ta kuptojnë, zakonisht e konsiderojnë si të pavërtetë. Ibni Mes'udi r.a. ka thënë:

*“Mos thuaj para njerëzve atë që nuk mund ta kuptojnë, sepse shkakton huti tek ata”.*¹²²

¹²⁰ "Fet'hul Bari", vëll. I, fq.307, nr.129.

¹²¹ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.304, nr.127.

7. Kujdesi nga dhënia fetva pa dijeni

Të dhënit fetva do të thotë: Përgjigjja e dijetarit ndaj pyetjes së parashtruar që ka të bëjë me çështje të ndryshme fetare apo nga legjislatura Islame.

Dhënia e fetvasë është çështje me përgjegjësi, prandaj kjo detyrë nuk mund t'u besohet njerëzve të paaftë dhe të pandërgjegjshëm. Transmetohet nga Ebu Hurejra se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Kush thotë një fetva pa mbështetje të arsyeshme, do të bartë mëkatin e atij që ia ka thënë atë fetva...”.*¹²³

Nga hadithi kuptojmë se dijetari që të ketë kompetenca për të dhënë fetva duhet plotësuar kushtet dhe njëherit duhet mbështetur në argumente të arsyeshme nga Kur’ani apo Sunneti i Pejgamberit s.a.v.s.. Transmetohet nga Abdull-llah b. Amr b. El-Asi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“All – llahu i Madhëruar nuk do t’ua marrë (njerëzve) dijen në atë mënyrë që do t’ua nxjerrë nga shpirtrat e tyre, por do t’ua marrë ashtu që do të bëjë të vdesin të diturit, pas së cilës në tokë nuk do të mbetet njeri i ditur i cili do t’u bëhej imam. Atëherë njerëzit vetes do t’i marrin për imam injorantët dhe do t’u shtrojnë pyetje të ndryshme fetare, kurse ata do t’u përgjigjen (japin fetva) pa dije përkatëse, me çka botën do ta lajthisin dhe vetveten do ta shkatërrojnë”.*¹²⁴

¹²² "Fet'hul Bari", nr.27. Kjo është thënie e Ibni Mes'udit gjatë shpjegimit të fjalës së Aliut.

¹²³ Transmeton Ebu Davudi, vëll.III, f.320, nr.3657.

¹²⁴ "Sahihul Buharij", vëll.I, fq.50, nr.100.

8. Kujdesi gjatë transmetimit të haditheve dhe ndalimi i shpifjes ndaj Pejgamberit s.a.v.s.

Ndalohet rreptësishtë t'i bësh shpifje Muhammedit s.a.v.s. Kjo vepër e shëmtuar bën pjesë në mëkatet e mëdha. I këtij mendimi është edhe Neveviu. Disa dijetarë të shkollës shafiite thonë se ai që i bën shpifje Muhammedit s.a.v.s. del nga radhët e Islamit.¹²⁵ Transmetohet se Enesi r.a. ka thënë:

:

{ }

*Më pengon të transmetoj shumë hadithe , meqë Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kush bën shpifje për mua me dashje, le t’ia sigurojë vendin vetes së tij në Xhehennem!”.*¹²⁶

*Ai i cili ia përcjell tjetrit thënien e Muhammedit s.a.v.s., duke e ditur se nuk është e tij, ai është gënjeshtar. Ai i cili ia transmeton tjetrit hadithin e Muhammedit s.a.v.s., duke dyshuar në besnikërinë (vërtetësinë) e tij, ai hyn në grupin e gabimtarëve të mëdhenj. Gjatë transmetimit të ndonjë hadithi me sened (burim) ose me domethënie të dyshimtë , nuk duhet të theksohet se atë e ka thënë Muhammedi s.a.v.s. Për hadith të tillë duhet thënë: “Thuhet se..., mendohet se ..., duket se ...” e të ngjashme.*¹²⁷

Transmetuesi që të mos bjerë në gabim duhet pasur kujdes për anën gjuhësore, stilistike, përmbajtjesore dhe logjike të hadithit.

¹²⁵ "Sahihul Buhari", në gjuhën shqipe, shiko komentimi vëll.I, fq.171, botuar në vitin 1995, Prishtinë.

¹²⁶ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.272, nr.108.

¹²⁷ "Sahihul Buhari", në gjuhën shqipe, shiko komentimi vëll.I, fq.172, botuar në vitin 1995, Prishtinë.

Besnikëria në transmetimin e haditheve shihet qartë tek sahabët (shokët) e Muhammedit s.a.v.s. Ata mjaft me rezervë i kanë transmetuar hadithet, duke u frikësuar se me pahir mund të bëjnë lëshime dhe në vend të shpërblimit të fitojnë dënimin.

Transmetohet nga Amir b. Abdullah b. Ez-Zubejri, e ky nga babai i vet, i cili ka thënë: I kam thënë Zubejrit:

: :
: . ()
. { } :

“Nuk dëgjoj që ti të transmetosh hadithe nga Pejgamberi s.a.v.s., siç transmeton filani e filani!” Sa më përket mua, unë nuk jam ndarë nga Pejgamberi s.a.v.s., por e kam dëgjuar duke thënë: “Kush bën shpifje ndaj meje me dashje le t’ia sigurojë vendin vetes së tij në xhehenem”¹²⁸

9. Kujdesi që mësimi të mos kalojë në monotoni

Pejgamberi s.a.v.s. ka mbajtur ligjërata dhe këshilla në xhami gjatë ditës, pas faljes së namazit. Ligjëratat i kishte të shkurtra dhe të qarta, prandaj dëgjuesit i kuptonin dhe i mbanin në mend.

Ibn Haxher El Askalani në librin e tij “Fet’hul Bari” thotë se Ebu Vaili ka thënë:

:
: .
()
.

¹²⁸ "Fet’hul Bari", vëll.I, fq.271, nr.107.

“Abdull-llahu i mësonte njerëzit çdo të enjte, prandaj një person i tha atij: O Ebu Abdurr-rahman, me të vërtetë, do të doja të na mësoje për çdo ditë”.

Ai u përgjigj: “Ajo që ma ndalon këtë është se nuk kam dëshirë që tua bëj të mërzitshëm (mësimin). Unë ju pajis me dijeni, ashtu siç na pajiste neve Pejgamberi s.a.v.s. Ai frikësohej se mos na kalojë në monotoni (mësimi)”.

¹²⁹

Në këtë hadith vërejmë se Pejgamberi s.a.v.s. kujdesej që këshillat dhe mësimi të mos u kalojnë atyre në monotoni duke u frikësuar se ngarkesa e tepërt me mësimë mund të shkaktojë braktisjen e mësimi.

¹²⁹ "Fet'hul Bari", vëll.I, fq.220, nr.70.

KAPITULL I SHTATË

VII

RUAJTJA E DITURISË

- FRIKA NDAJ ALLAHUT
- KUPTIMI
- MEMORIZIMI
- MËSIMI
- PËRSËRITJA
- PRAKTIKIMI
- PËRHAPJA

RUAJTJA E DITURISË

Dituria, e cila është dhurata më e çmuar e Allahut të Madhëruar pas Imanit, arrihet duke lexuar, duke përsëritur mësimet, duke prezantuar në ligjëratat e dijetarëve, nëpër mexhliet e tyre. Mirëpo, ndodhë që dituria të dobësohet dhe të harrohet.

Ndër masat që i ndërmerret dijetari, që diturinë e tij ta ruaj dhe që mos t'i kalojë në harresë, janë:

1. FRIKA NDAJ ALLAHUT
2. MËSIMI
3. KUPTIMI
4. MEMORIZIMI
5. PËRSËRITJA
6. PRAKTIKIMI
7. PËRHAPJA

1. Frika ndaj Allahut

E para, që dijetari duhet të merr masa në ruajtjen e diturisë që e ka, është kujdesi që ai vazhdimisht ta ketë frikën ndaj All-llahut. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.(...)

“Keni frikë All-llahun se All-llahu ju dhuron dituri, ...”.

(El-Bekare, 282)

Dijetarët janë të mendimit se nga ky ajet kuptohet ajo se, nëse i frikësohesh Allahut, Ai të jep dituri. Edhe dituria është rizik nga Allahu i Lartmadhëruar.

Transmetohet prej Ibn Abasit r.a. se ka thënë:

*“Vërtet e mira ..., e shton dhe e zgjeron rizkun,
Vërtet e keqja ..., e pakëson rizkun”.*

E nëse nuk e ke frikë Allahun për mëkatet e tua, atëherë dije se dija e jote do të pakësohet. Imam Shafiu i ka thënë këto vargje:

*“U ankova te Allahu për vështirësi në të mbajturit
përmendësh
Më udhëzoi që të largohem prej mëkateve
Më tha: Dituria është dritë
Ndërsa drita e Allahut nuk i dhurohet mëkatarit.*

2. Mësimi

Mësimi është çështja e parë që e bënë kërkuesi i diturisë për ruajtjen e diturisë, qoftë ai me anë të leximit apo të dëgjimit.

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

و إنما العلم بالتعلم .

*“Dijenja arrihet vetëm duke mësuar”.*¹³⁰

Prandaj një fjalë e urtë thotë:

“Kërko diturinë prej djepi deri në varr”.

Mirëpo, nëse kërkuesi i diturisë (dijetari) e ndërpret mësimin, gjegjësisht leximin, atëherë dituria e tij dobësohet dhe harrohet.

Nëse dijetari vazhdon me lexim, atëherë mësimi dhe leximi i tij vetëm sa ia përforcon diturinë që e ka pasur, si dhe e thëllon më shumë në njohuritë e reja.

¹³⁰ Buhariu "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Sherh Sahihul Buhari", boton Darul Fikri, Bejrut-botimi i parë 1993 vëll. I, Fq.216 h.67

3. Kuptimi

Nuk ka dobi nga mësimi, i cili nuk është kuptuar si duhet. Mësimi i tillë harrohet shpejt dhe vështirë mund të ruhet.

أَنَّ عَائِشَةَ زَوْجَ النَّبِيِّ (صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ)
كَانَتْ لَا تَسْمَعُ شَيْئًا لَا تَعْرِفُهُ إِلَّا رَاجَعَتْ فِيهِ حَتَّى تَعْرِفَهُ، ...

*“Transmetohet nga Ibni ebi Mulejke, se Aishja, bashkëshortja e Pejgamberit s.a.v.s., kur ka dëgjuar diçka e që nuk e ka kuptuar si duhet, është kthyer në atë çështje derisa e ka kuptuar mirë...”*¹³¹

Shejh Burhan el-Islam e ka këshilluar nxënësin e tij që të mos e shkruajë atë që nuk e ka kuptuar, për shkak se ajo e shton mërzinë dhe zhdukë inteligjencën.

4. Memorizimi

Nuk ka diskutim se memorizimi i asaj që mëson (lexon) kërkuesi i diturisë është metoda më efikase për ruajtjen e diturisë.

Nëse krahasojmë shekullin në të cilin jetojmë, me shekullin në të cilin u shpall Kur’ani; sot është shekulli apo koha e shkrimit (shkrimit të librave të shumtë dhe kompjuterizimit), përderisa koha në të cilën jetoi Muhammedi s.a.v.s. dhe sahabët e tij ishte koha e memorizimit; sot me qindra e mijëra informata, dokumente e të dhëna të tjera shkruhen në vëllime librash dhe kompjuter, ndërsa në kohën e Pejgamberits.a.v.s. dhe sahabëve të tij, me qindra e mijëra hadithe e poezi të ndryshme kanë mbajtur në mend. Ebu Hurejra ka thënë:

¹³¹ Buhariu, "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", boton Darul Fikri- Bejrut, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.266 h.103

“Nuk ka nga shokët e Pejgamberit s.a.v.s. dikush që dinë hadithe më shumë se unë, përveç Abdullah ibn Amrit, sepse ai i shkruante, e unë jo”.¹³²

Buhariu, ndër dijetarët më të njohur të shkencës së hadithit, për vete thoshte se i mësonte njëqind mijë Hadithe Dajif dhe njëqind mijë Sahih.¹³³ Ndërsa Ebu hurejre, transmetuesi më i njohur i haditheve, thuhet se ka ditur përmendësh mbi pesë mijë hadithe.

Nga kjo kuptojmë sememorizimi i asaj që e lexojmë (mësojmë) është metodë efikase për ruajtjen e diturisë. E nëse ndokush e ka memorien e dobët dhe nuk mbanë mend, atëherë diturinë e tij le ta ruaj me përdorimin e shkrimit.

“Ruajeni diturinë e fituar duke e shenuar (shkruar)”.¹³⁴

عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: لما فتحت مكة قام النبي صلى الله عليه وسلم فذكر الخطبة خطبة النبي صلى الله عليه وسلم . قال: فقام رجل من أهل اليمن يقال له أبو شاه ، فقال: يا رسول الله اكتبوا لي ، فقال: اكتبوا لأبي شاه .

Nga Ebu Hurejra r.a. transmetohet se: *kur u çlirua Mekeja u ngrit një njeri nga banorët e Jemenit, të cilin e quanin Ebu Shahi dhe tha: “O i Dërguar i All-llahit, na shkruani mua (fjalimin). Pejgamberi s.a.v.s. tha: Shkruani Ebu Shahit (Fjalimin)”*.¹³⁵

¹³² Buhariu "Buhariu, "Fethul Bari", Ibn Haxher el Askalani, libri "Shehr Sahihul Buhari", h. 113

¹³³ Hedju sari mukddime Sahihil Buhari, Ibni Haxher, f. 512

¹³⁴ (Ibn Abd el Ber, "Xhemiul Bejanil ilmi)

¹³⁵ Transmeton Tirmidhiu vëll. III, f. 318, h. 3649

5. Përsëritja

Diturinë mund ta simbolizojmë me devenë, ndërsa përsëritjen e saj me litar. Prandaj, pronari i diturisë duhet që ta lidhë devenë e tij me litar të fortë.

Transmetohet nga Ibni Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

إِنَّمَا مَثَلُ صَاحِبِ الْقُرْآنِ كَمَثَلِ الْبَابِ الْمُعَقَّلَةِ ، إِنْ عَاهَدَ عَلَيْهَا ، أَمْسَكَهَا ، وَإِنْ أَطْلَقَهَا ذَهَبَتْ .

“Vërtetë shembulli i një hafidhi të Kur’anit, është sikur shembulli i një deveje të lidhur - nëse gjithnjë e mban lidhur do ta ketë atë, e nëse e lëshon, do t’i shkojë”.¹³⁶

Pra, nëse hafidhi i Kur’anit gjithnjë e lexon (e përsëritë) atë, do të mbetet hafidh i tij, përndryshe do ta harrojë.

Një shkencëtar thotë: “Një specialist bashkëkohor duhet të llogarisë se prej 10 deri në 20 % (përqind) e informatave janë vjetruar, prandaj ai duhet t’i përsërisë ato.

Përsëritja e mësimit do të ndikojë në kuptimin e mësimit, përforcimit të diturisë dhe të kuptuarit e gjërave të pa kuptueshme, prandaj është thënë:

“Përsëritja e dy rreshtave është më e dobishme sesa leximi i disa librave”.

¹³⁶ Muttefekun alejhi, "Rijadus Salihin", Imam En Nevevij, boton Darus Selam, Kajro, botimi i parë 1993 vëll. I, fq.192 h.1003

6. Praktikimi

Ai që vepron sipas asaj që e di, kjo shkakton që ajo dije të mbetet dhe të ngulitet më fuqishëm në mendjen e tij. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

.()

“Po sikur të zbatonin atë që këshilloheshin do të ishte më mirë për ta dhe do t'i përforconte më shumë”. (*En-Nisa, 66*)

Ai që vepron me atë që e di, All-llahu i dhuron dijen e asaj që nuk e di.

“Kurse ata që e gjetën rrugën e drejtë, Ai atyre u shton edhe më udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë edhe më të devotshëm”. (*Muhammed, 17*)

7. Përhapja

S'ka dyshim se ajo që ndikon në përforcimin e asaj që e di dhe ngulitjen e saj në mendje, që të mos harrohet, është edhe përhapja e diturisë, mësimi i saj të tjerëve apo debati (diskutimi) në mes të nxënësve të diturisë.

Një fjalë e urtë thotë:

“Dituria është më e mirë se pasuria. Sepse, derisa ti e mbron pasurinë, dituria të mbron ty. Gjatë përdorimit pasuria pakësohet, ndërsa dituria shtohet”.

Një poet ka thënë: *“Mësimi vjen nga kuptimi, memorizimi, meditimi dhe debati”.*

Tek dijetarët (Ulemaja) ka një rregull:

“Ai i cili nuk i mëson të tjerët, nuk mësohet dhe nuk e përforcon diturinë e vet asnjëherë”.

.....
E lus Allahun që të na falë neve, prindërit tanë dhe gjithë besimtarët, ndërsa pasardhësit tanë të na i udhëzojë në rrugën e drejtë.

Përsosmëria i takon vetëm Allahut të Gjithëdijshtëm.

Subhaneke All- lllahumme ve bi hamdike,

eshhedu en la ilahe il-la ente,

estegfiruke ve etubu ilejke.

.

.

.

LITERATURA E KONSULTUAR

1. Kur'ani (përkthim me komentim), në gjuhën shqipe, H. Sherif Ahmeti, Medine 1992.
2. "Sahihul Buhari" vëll.I, III dhe V, botimi i dytë 1987,
3. "Sahihul Muslim", vëll.I, III dhe IV, Bejrut.
4. Ibn Haxher el Askalani, "Fet'hul Bari", vëll.I, boton Darul Fikri, botimi i parë, Bejrut 1993.
5. "Sunen Ebu Davud", vëll.III dhe IV, Darul Fikri, Bejrut.
6. "Sunenu Tirmidhij", vëll.V, Bejrut.
7. Muhamed bin Jezid Ebu Abdullah El-Kazvini, "Sunen Ibni Maxheh", vëll.I, Bejrut.
8. Ahmed bin Hanbel, "Musned Ahmed" vëll.II dhe V, gjipt.
9. Hakimi, "Mustedrek", vëll.I.
10. Taberani, "El-Mu'xhemul Evset", vëll.IV, Kajro 1994.
11. Muhamed bin Selmete bin Xha'fer Ebu Abdull-llah El-Kuda'iju, "Musned Esh-Shihab", vëll.II, botimi i dytë 1986, Bejrut.
12. Muhamed ibn Harun Err-Rrujanij Ebu Bekr, "Musned Err-Rrujanij", vëll.I, botimi i parë, 1995 Kajro.
13. Taberani, "El Kebir", vëll.XI dhe XIII botimi i dytë 1983, Mosul.
14. Er-Rrabi, "Musnedurr Rrabi'a" vëll.I, botuar në vitin 1995, Bejrut.
15. Taberani "Mexhmeus-Sagir", vëll.I, Bejrut viti 1985.
16. Imam En-Nevevij, "Rijadus-Salihin", boton Darus Selam, botimi i parë 1993, Kajro.
17. Alij bin Ebi Bekr El-Hejthemiju, "Mexhmeuz - Zevaid", vëll.I .
18. Muhammed Nasirudin Albani, "Sahihut-Tergibi vet-Terhibi" nga vëll.I.

- 19.Imam Gazali, "Ihja Ulumud din", vëll.I, botimi i dytë, 1316 hixhrij-1895, botuar në shtypshkronjën e Ez-herit në Egjiptit.
- 20."Sahihul Buhari" në gjuhën shqipe, vëll.I, botimi i parë, 1994, Prishtinë.
- 21.Mr. Musa Vila, "Komentimi i Haditheve sipas metodologjisë shkencore", 2002 Prishtinë.
- 22.Dr. Jusuf Kardavit, "Err-rresul vel Ilm"- "Pejgamberi a.s. dhe Dituria" (në gjuhën shqipe).
- 23.Sulejman Osmani "Sunneti bazë e Sheriatit", 1996 Gjilan.
- 24."Takvimi 2004" tema "Ajeti "El-Kursijj" dhe vlera e tij".
Mr.Xhabir Hamiti.

PËRMBAJTJA:

KAPITULLI I PARË

VLERA DHE RËNDËSIA E DITURISË DHE E DIJETARËVE	7
DITURIA NIMET–DHURATË NGA ALL-LLAHU I MADHËRUAR	10
DISA NGA DOBIT-FRYTET E DITURISË	13
DITURIA KULMINACIONI I IBADETIT	16
a) Vlera e diturisë ndaj ibadeteve vullnetare	16
b) Vlera e diturisë ndaj xhihadit	17
QORTIMI I INJORANCËS DHE TË PADITURVE.....	15
DITURIA I LARTËSON DIJETARËT MBI TË TJERËT	22
Menjëherë pas melekëve, në gradë janë, dijetarët e drejtë	24
Dijetarët janë pas pejgamberëve	25
Detyrë e të paditurit është ta pasojë të diturin edhe nëse i dituri është më i ri se ai	26
a) Pejgamberët kërkojnë dituri edhe te ata që janë nën ta	27
b) Nganjëherë ai i cili është në grade më të ulët mundë t’i afrohet diturisë më shumë se ai i cili është në grade më të lartë	28

KAPITULLI I DYTË

APELIMI I HADITHEVE PËR HULUMTIM, STUDIM, SPECIALIZIM	33
KËRKIMI I DITURISË RRUGA PËR NË XHENNET.....	35
UDHËTIMI PËR KËRKIMIN E DITURISË	37
SHOQËRIMI ME TË DITURIT	39
KËSHILLIMI ME TË DITURIT	40
DITURIA NUK KA KUFIJ	41
DITURIA ARMË E FORTË KUNDËR SHEJTANIT	42
VLERA E LEXIMIT TË KUR’ANIT, HADITHEVE TË PEJGAMBERIT s.a.v.s. DHE E DICIPLINAVE TË TJERA SHKENCORE	46
a. Vlera e leximit të Kur’anit	46
b. Vlera e leximit të haditheve të Muhammedit s.a.v.s.	47
c. Vlera e leximit të disiplinave tjera shkencore	49

KAPITULLI I TRETË

DITURIA PËRGJEGJËSI DHE SHËRBIM NDAJ MISIONIT FETAR	55
VLERA E ATIJ I CILI I MËSON TË TJERËT	56
OBLIGIMI I DIJETARËVE PËR SHPËRNDARJEN E DITURISË..	57
NXITJA PËR PËRHAPJEN E DITURISË DHE MOSFSHEHJA E SAJ	61
- Kërcënimi ndaj atyre të cilët e fshehin diturinë	62

KAPITULLI I KATËRT

KËRKIMI I DITURISË DETYRË EDHE E FEMRAVE MUSLIMANE	66
CAKTIMI I LIGJERATAVE VETËM PËR GRA	67
GRATË E GJENERATËS SË PARË TË MUSLIMANËVE- GRATË E PEJGAMBERIT s.a.v.s. DHE GRATË E SAHABËBE ...	68

KAPITULLI I PESTË

NGA METODOLOGJIA E LIGJËRIMIT TË MUHAMMEDIT s.a.v.s.	72
TË PARASHTRUARIT E PYETJEVE PARA DËGJUESËVE	72
PËRSËRITJA E FJALËVE NGA TRI HERË ME QËLLIM QË TË KUPTOHET MË MIRË	73
PËRDORIMI I DUARVE PËR KONKRETIMIN E QËSHTJEVE GJATË LIGJËRIMIT	74
TË FOLURIT E QARTË	75

KAPITULLI I GJASHTË

ÇKA DUHET PASUR KUJDESE KËRKUESI I DITURISË (DIJETARI)	78
FRIKA NDAJ ALL-LLAHUT TË MADHËRUAR	78
NIJETI I SINQERT	79
- Kërcënimi ndaj atij i cili mëson për lavdërim	81
TURPI GJATË KËRKIMIT TË DITURISË	83
TË VEPRUARIT ME ATË QË E DI	84

a) Të vepruarit me diturinë që e ke mësuar	84
b) Qortimi i urdhërimit të tjerëve atë të cilën vet nuk e punon	86
MOSTREGIMI I NDONJË LLOJI TË DITURISË PËR SHKAK TË SITUATËS DHE SIGURISË	88
KUJDESI QË TË NJOFTOHEN VETËM DISA NGA FRIKA E KEQKUPTIMIT NGA TË TJERËT	90
KUJDESI NGA DHËNIA FETVA PA DIJENI	91
KUJDESI GJAT TRANSMETIMIT TË HADITHEVE DHE NDALIMI I SHPIFJES NDAJ PEJGAMBERIT s.a.v.s.	92
KUJDESI QË MËSIMI TË MOS KALOJË NË MONOTONI	93

KAPITULLI I SHTATË

RUAJTJA E DITURISË	96
FRIKA NDAJ ALLAHUT	96
MËSIMI	97
KUPTIMI	98
MEMORIZIMI	99
PËRSËRITJA	100
PRAKTIKIMI	101
PËRHAPJA	101
LITERATURA E KONSULTUAR	103
PËRMBAJTJA	105

Donatorë:
FAMILJA E ISMAL NIKËS

Autori i shprehë mirënjohje Ismal Nikës, djemve dhe bijave të tij, njëherit e lus Allahun që t'i shpërblejë në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe t'i ngritë ata në shkallë të larta me peygamberët, dëshmorët, të sinqertit dhe bamirësit.